# STRATEGJIA E LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MIGRIMIT ILEGAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

# PLANI AKSIONAL NACIONAL I LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MIGRIMIT ILEGAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

# PLANI AKSIONAL NACIONAL I LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT ME FËMIJË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
KOMISIONI NACIONAL
I LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MIGRIMIT ILEGAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

# STRATEGJIA E LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MIGRIMIT ILEGAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

# PLANI AKSIONAL NACIONAL I LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MIGRIMIT ILEGAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

# PLANI AKSIONAL NACIONAL I LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT ME FËMIJË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Dezeni dhe përgatitja grafike:
Skenpoint

Tirazhi: 1000 kopje

osce
Organization for Security and Co-operation in Europe
Spillover Monitor
Mission to Skopje

Botimi është mbështetur nga Misoni mbikqyrës i OSBE-së në Shkup.

Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të thotë se e përfaqëson këndvështrimin dhe qëndrimin e Misionit Vëzhgues të OSBE-së në Shkup.

# PARATHËNIE

Kriminaliteti si fenomen me parashenjë negative shoqërore, si një fenomen i dëmshëm në shoqëri si edhe si fenomen i rrezikshëm për funksionimin e suksesshëm të sistemit juridik, ekonomik, social si dhe të sistemeve të tjera, gjen bazë të volitshme për zgjerim dhe zhvillim në shtetet të cilat gjenden në krizë politike, ekonomike, sociale dhe juridike ose që janë në tranzicion. Proceset e tranzicionit në ditën e sotme po realizohen me dinamikë të madhe dhe me një tendencë për t`i ngërthyer të gjitha segmentet e strukturës shoqërore si edhe të gjitha shtresat në shoqëri. Mu për këtë arsye, sipas një rregulle, ata krijojnë gjendje të cilat E. Dirkem i definoi si gjendje të anomisë (paligjshmërisë) e cila vetvetiu prodhon dezorganizim shoqëror në të gjitha nivelet e mundshme të funksionimit të shtetit dhe të shoqërisë. Këto gjendje kanë një ndikim reaktiv në paraqitjen e kriminalitetit në të gjitha shtresat e jetës shoqërore. Ato prodhojnë situata që ndihmojnë kriminalitetin të depërtojë thellë në të gjitha lëmenjtë e jetës, ndërsa karakteristikat e tij fenomenologjike të paraqiten në forma dhe lloje të reja edhe më të rrezikshme. Mu për këto arsye gjithnjë e më shumë imponohet nevoja që këto shtete të ndërtojnë politikën e tyre kundër kriminalitetit të vendosur në bazë shkencore për parandalim më të suksesshëm të kriminalitetit, si edhe për pengimin dhe evitimin e tij. Një politikë e tillë për kriminalitetin paraqet një strategji të veçantë të luftës kundër kriminalitetit, sepse faktorët kriminogjen të cilët edhe e kushtëzojnë paraqitjen e tij në lëmenj të ndryshëm të jetës, veprojnë me intensitet të ndryshëm, ndërsa mënyra e ngadhënjimit mbi ta dhe e evitimit të tyre kërkon gjithmonë qasje specifike në varëshmëri me këto marrëdhënie.

Në këto kushte të përhapjes së shpejtë të kriminalitetit në të gjitha lëmenjtë e jetës, me elemente organizimi, me përfshirje të një numri të madh pjesëmarrësish, me elemente internacionalizimi, pa njohje të asnjë lloj kufiri, veçanërisht në përhapjen e kriminalitetit të prodhimit dhe trafikimit të palejueshëm të narkotikëve të ndryshëm, trafikimit të armëve dhe mbeturinave nukleare, depërtimit tejet të madh në treg të tyre me shenja të falsifikuara për cilësinë dhe origjinën e tyre, e "prodhuan" dhe e nxitën aktivitetin kriminalistik në sferën e trafikimit me qenie njerëzore si edhe migrimin ilegal. Shenja themelore e aktivitetit të këtillë kriminalistik është eksploatimi seksual, puna e detyrueshme (me dhunë) etj.

Dëmet e paevitueshme që po i pësojnë shtetet nga format e ndryshme të fenomeneve negative të këtij kriminaliteti me elemente transnacionale, në këto kushte bashkëkohore, pasqyrohen në mënyrë negative në funksionet thelbësore të jetës shoqërore, e cila nxit Qeveritë për të ndërmarrë masa energjike për përgjigje adekuate (gjegjëse) ndaj strukturave kriminalistike për shpartallimin e tij. Kjo strategji, e përpiluar nga një ekip ekspertësh, të ndihmuar nga një grup më i gjerë njerëzish me proveniencë (prejardhje) të ndryshme, të kyçur në një farë mënyrë me luftën kundër kësaj të keqeje, strategji kjo e nxjerrë dhe e miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë e vërteton faktin se shteti ynë ka politikë konzistente dhe qëllim që të japë kontributin e tij në luftën kundër organizatave të këtilla kriminalistike dhe llojit të këtij kriminaliteti të organizuar.

Mendoj se edhe me përqafimin e kësaj strategjie qëllimi nuk do të arrihet përfundimisht, mirëpo multidimensionaliteti i saj do të mundësojë realizimin e aktiviteteve në lëmenj të veçantë, veprim ky që do të sjellë zvogëlimin i hovit të trafikimit me qenie njerëzore, kontrabandimit të migrantëve, si edhe të të gjitha formave të tjera, të cilat vetëm e lehtësojnë ekzistimin e këtij fenomeni kriminalistik në korniza minimale, me se do ta bënim edhe vetë qëllimin të realizueshëm.

Prandaj, kënaqësia ime është shumë e madhe kur e shoh se ky dokument do t`i kontribuojë luftës më të suksesshme kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimit ilegal, si një të keqeje shoqërore ndërkombëtare.

d-r Goce Xhukleski
Sekretar shtetëror
Ministria për Punë të Brendshme
dhe Kordinator Nacional

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
KOMISIONI NACIONALPËR LUFTË KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ
DHE MIGRIMIT ILEGAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

# STRATEGJIA E LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MIGRIMIT ILEGAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

**Shkup, mars 2006**

# PËRMBAJTJA

1. Hyrje ..... 7

2. Prapavija - Analiza e historisë së gjendjes lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore ..... 9

3. Korniza institucionale ..... 10

4. Parimet udhëheqëse ..... 11

4.1. Legjislativa ..... 11
4.2. Bashkëpunimi ndërkombëtar ..... 12
4.3. Edukimi ..... 14

5. Qëllimet strategjike dhe specifike ..... 16

- Korniza mbështetëse ..... 16
- Preventiva ..... 16
- Mbështetja dhe mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve ..... 16
- Hetimi dhe ndjekja penale e viktimave ..... 17

6. Implementimi ..... 18

Me strategjinë e luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë, Komisioni Nacional ka për qëllim të përcaktojë drejtimet dhe prioritetet për t`u ballafaquar me këtë fenomen kriminalistik.

Duke u nisur nga dispozitat kushtetuese me të cilat korpusi i lirive dhe i të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarëve, si edhe respektimi i normave, të pranuara në përgjithësi, të së drejtës ndërkombëtare përcaktohen si parime fundamentale të renditjes kushtetuese, dhe duke i pasur në konsiderim Marrëveshjen për stabilizim dhe asociim dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit transnacional të organizuar me protokollet e saj, Republika e Maqedonisë në vitin 2002 e përpiloi Programin nacional për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimin ilegal me një qëllim të vetëm të inkuadrohet në mënyrë aktive në përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për parandalimin dhe për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore, si njërën ndër format më të vështira të krimit të organizuar. Shembull shumë i qartë për verifikimin e një qëndrimi të këtillë paraqet legjislativa ekzistuese, e cila sado qoftë e harmonizuar, do të ketë vlerë të kufizuar, nëse nuk e ka mbështetjen e strukturave qeveritare dhe dëshirën (vullnetin) politike për aplikimin e saj të drejtpërdrejtë dhe të pakushtëzuar.

Në këtë drejtim janë edhe të gjitha aktivitetet që janë ndërmarrë, para së gjithash, me qëllim të kujdesit të cilin e ushtron shteti për të plotësuar sigurinë dhe integritetin personal të qytetarëve për mbrojtjen e tyre nga aktivitetet e organizatave kriminele që merren me trafikimin e qenieve njerëzore dhe me kontrabandimin e migrantëve, që paraqet edhe një segment, përkrahës të tjerëve, për përpilimin e programit nacional për luftën kundër kësaj të keqeje të shekullit të 21-të.

Në këtë program janë adresuar aktivitetet që ndihmojnë zbulimin e lidhjeve të shkakut dhe të pasojës me ndikim të caktuar trafikimin e qenieve njerëzore në planin nacional si edhe në planin rajonal, zbulimin e bartësve të këtyre aktiviteteve kriminele, metodologjinë e punës që praktikohet gjatë saj, masat e ndërmarra gjer tani në planin e parandalimit, si edhe veprimet të cilat ndërmerren për ndjekjen penale dhe për mbrojtjen e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Për shkak të ndërlikueshmërisë së fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore, që implikon korrelacion me format e tjera të krimit të organizuar për arsye të globalizimit dhe mosekzistimit të kufijve midis shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, gjë që edhe mundëson transnacionalitetin e tij, prandaj paraqitet si domosdoshmëri nevoja që strategjia nacionale, në ta ardhmen, të funksionojë duke u bazuar në qasjen metodologjike multidisciplinare gjatë shfrytëzimit të praktikave dhe të dhënave lidhur me eksperiencën e shteteve të tjera të rajonit si edhe më gjerë, me qëllim të luftës sa më të suksesshme kundër kësaj forme më të vështirë të robërisë së sofistikuar.

Republika e Maqedonisë, që nga themelimi (etablimi) i Komisionit Nacional, kaloi nëpër disa faza dhe bëni hapa të rëndësishëm në drejtimin e harmonizimit të kornizës legjislative me standardet e Bashkimit Evropian në fushën e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Më rëndësi të jashtëzakonshme është të punohet në ndërmarrjen e veprimeve me të cilat do të thellohen aktivitetet që gjer më tani kanë qenë operacionalizuar në planin parandalues me një qëllim të vetëm që të pengojnë gjatë këtij lloji të krimit të organizuar. Në këtë drejtim, edhe në të ardhmen, aktivitetet do të drejtohen kah rivendosja dhe reduktimi i faktorëve ekonomikë dhe socialë që ndikojnë në përfaqësimin procentual të viktimave gjatë trafikimit me qenie njerëzore:

- Identifikimi i shkallës së dhunës familjare;
- nxitja dhe bashkëpunimi midis institucioneve qeveritare dhe sektorit joqeveritar me pjesëmarrje në projektet hulumtuese lidhur me problemin e trafikimit të qenieve njerëzore;
- promovimi i projekteve me të cilat do të implementohen programe për reintegrimin ekonomik të grupeve të rrezikuara.

Parandalimi, identifikimi, ndihma e dhënë, mbështetja, mbrojtja si edhe kthimi dhe reintegrimi i viktimave, ndjekja adekuate penale, bashkëpunimi ndërkombëtar, edukimi i kapaciteteve të institucionalizuara, koordinimi, vendosja e një sistemi të unifikuar të informimit, si dhe ndikimi informativ – propagandistik mbi mendimin publik janë pjesë përbërëse edhe e kësaj strategjie.

Nomenklatura e përgjithshme nacionale e inkuadruar në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore e shpreh dëshirën (vullnetin) që përfitimet e tilla progresive të institucionalizohen si edhe të shpërblehen.

# PRAPAVIJA – ANALIZA E HISTORIATIT TË GJENDJES SË T RAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Trafikimi me qenie njerëzore, në veçanti me femra dhe fëmijë, është një problem i përgjithshëm i cili pasqyrohet edhe në Republikën e Maqedonisë. Ai paraqitet në forma të ndryshme dhe ka për qëllim, që nëpërmjet formave të ndryshme të eksploatimit, të shfrytëzojë viktimën për një profit sa më të madh.

Në bazë të analizave të kryera prej shërbimeve të specializuara në Ministrinë e Punëve të Brendshme, viktima të trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Maqedonisë më tepër kanë qenë vajzat dhe gratë me origjinë nga shtetet e ish Bashkimit të Republikave Sovjetike si edhe ato që u takonin bllokut të shteteve socialiste[1], që hynin në mënyrë ilegale ose nëpërmjet të rrjetave tanimë të themeluara për tranzitimin ilegal të migrantëve në Republikën e Maqedonisë, ndërsa një pjesë e tyre hynin edhe në mënyrë legale në shtetin tonë. Sipas njohurive me të cilat disponojmë, një pjesë e femrave – viktima të trafikimit me qenie njerëzore të cilat në mënyrë të palejuar e kanë kaluar kufirin shtetëror të Republikës së Maqedonisë, nëpërmjet të kanaleve të organizuara janë transferuar në shtetet fqinje ku për një shumë të caktuar shpërblimi financiar u janë shitur grupeve të organizuara kriminele në këto shtete, ndërsa një numër më i vogël i tyre janë transferuar në Itali dhe në shtetet e tjera të Evropës Perëndimore. Në fushën e migrimit ilegal, e në bazë të eksperiencës së deritanishme policore, territori i Republikës së Maqedonisë shfrytëzohet si një shtet tranzicioni. Në këtë rast më aktuale kanë qenë kalimet ilegale nëpërmjet të korridorit perëndim – lindje, veri - jug.

Një pjesë më e vogël e personave të gjinisë femërore, të futur në mënyrë ilegale në Republikën e Maqedonisë, më shpesh ndalen në pjesën perëndimore të shtetit, ku nëpërmjet premtimeve të ndryshme të rrejshme për punësim në objektet e hotelerisë inkuadrohen në vargun e shitjes së tyre ilegale dhe mashtrim deri në prostitucion. Përveç shtetaseve të huaja, në kohën e fundit janë regjistruar edhe disa shtetase të Republikës së Maqedonisë, më shpesh persona të mitur, të cilët mashtrohen deri në prostituimin e tyre, me se zmadhohet mundësia  e futjes së tyre në vargun e trafikimit të qenieve njerëzore.

Në bazë të rezultateve analitike të vështruara në numrin më të madh të rasteve të parealizuara bëhet fjalë për fenomenin e prostituimit të detyruar të shtetaseve të huaja në banesa të marra me qira ose në banesa private, shtëpi, si edhe në shtëpitë e pushimit (vilat). Kontrollimi i objekteve të tilla është, në veçanti, i nevojshëm duke pasur në konsiderim se këto nuk janë vetëm vende ku kryhet prostituimi i detyruar me dhunë, por edhe vende ku fshihen viktimat e trafikimit me qenie njerëzore deri në shitjen e tyre përfundimtare.

*1. (Moldova, Romania, Russia, Belarus, Ukraine, Bulgaria)*

# KORNIZA INSTITUCIONALE

Qeveria e Republikës së Maqedonisë duke reaguar në mënyrë të vendosur kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimit ilegal, duke dashur të arrijë një nivel sa më të lartë të efikasitetit dhe veprimit të përbashkët në luftën kundër këtyre fenomeneve në shtetin tonë, solli vendimin për themelimin e Komisionit Nacional për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë[2]. Në bazë të këtij vendimi, Qeveria solli vendimin për emërtim të koordinatorit nacional dhe të anëtarëve të Komisionit nacional[3].

Në përputhje me këtë vendim, Komisi-oni Nacional ka për detyrë të ndjekë dhe të analizojë gjendjen e trafikimit me qenie njerëzore dhe migrim ilegal dhe të koordinojë aktivi-tetet me institucionet gjegjëse, organizatat ndërkom-bëtare dhe joqeveritare të cilat janë involvuar në zgjidhjen e problemeve në këtë lëmë.

Sekretariati është një organ i cili funksionon në kornizat e Komisionit Nacional, ndërsa sekretari i realizon vendimet e Komisionit dhe e përfaqëson këtë organ, në të cilin marrin pjesë edhe përfaqësues të organizatave joqeveritare ndërkombëtare[4] dhe ekspertë të institucioneve qeveritare. Në suazat e Komisionit Nacional është themeluar një nëngrup për luftën kundër trafikimit të fëmijëve.

*STRUKTURA E KOMISIONIT NACIONAL PËR LUFTË KUNDËR TREGËTISË ME NJERËZ DHE MIGRIMIT ILEGAL*




2. *Vendimi është shpallur në („Gazeta Zyrtare e RM", nr. 18/2001)*

3. *Urdhri është shpallur në („Gazeta Zyrtare e RM", nr. 19/2001, 26/2002)*

4. *OSBE, IOM, UNDP, ICMPD, USAID, UNICEF, programet e Ambasadës së SHBA-ve – ICITAP dhe OPDAT.*

## 1. Legjislativë

Me gjithë përparimin evident në tejbartjen e vendimeve të standardizuara legjislative të Bashkimit Evropian, rendi i brendshëm juridik në këtë fushë të veprimtarisë duhet të plotësohet, veçanërisht në drejtimin e përpilimit të rregulativës nënligjore me të cilat duhet operacionalizuar vendimet ligjore të adoptuara ose që janë në fazë të adoptimit, duke i pranuar vlerat fundamentale, që lidhen me të drejtat e njeriut dhe me qasje kah orientimi i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

Duke i mbështetur përpjekjet dhe aktivitetet e komunitetit ndërkombëtar për një përgjigje më efikase dhe të koordinuar ndaj formave në rritje të të trafikimit me qenie njerëzore, në pjesën e aktiviteteve legjislative është bërë plotësimi i Kodit penal me dy inkriminime të reja, në përputhje me Protokollin për parandalim, shpartallim dhe ndëshkim të trafikimit me qenie njerëzore, në veçanti me femra dhe fëmijë me të cilin plotësohet  Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit transnacional të organizuar, të cilën Republika e Maqedonisë e ka nënshkruar në dhjetor të vitit 2000.

Pas nënshkrimit dhe ratifikimit të Marrëveshjes për stabilizim dhe asociim me Bashkimin Evropian në vitin 2004, Republika e Maqedonisë në pjesën e Marrëveshjes, që lidhet me nënkapitullin  -drejtësi dhe punë të brendshme, është e obliguar të bëjë harmonizimin e legjislatives në drejtim të bashkëpunimit më efikas në luftën kundër formave më të rënda të krimit të organizuar, dhe në këtë kontekst edhe për trafikimin me qenie njerëzore. Qëllimi strategjik i Qeverisë së Repsublikës së Maqedonisë gjatë vitit 2004 ishte lufta kundër krimit të organizuar, madje edhe më tepër nëse kihet në konsiderim se Konventa e Palermos me Protokollet e saj thekson nevojën për themelimin e një kornize të vetme dhe efikase juridike si parakusht thelbësor për dhënien e përgjigjes më të fortë dhe më të qëndrueshme në luftën kundër këtij lloji të sofistikuar të robërisë në shekullin e 21-të.

Në këtë drejtim, si aktivitete prioritare të Komisionit Nacional, të operacionalizuar në periudhën e kaluar, ishin aktivitetet për reformat e legjislacionit penal me qëllim të mbindërtimit të kornizës ligjore për parandalim dhe shpartallim më efikas të veprave të lidhura me trafikimin me qenie njerëzore.

Përveç këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve në legjislacionin prej vitit 2002, procesi i harmonizimit të legjislacionit penal vazhdoi edhe në vitin 2004, kur u miratuan ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Penal në dispozitat e Nenit 418-ndërsa me inkuadrimin e veprimeve të reja të realizimit të paragrafit 1 në prezantimin e dy paragrafëve 6 dhe 7, që lidhen me ndëshkimin e personave juridikë dhe me marrjen e sendeve dhe mjeteve të përdorura në kryerjen e veprës penale, si dhe me ndryshimet në Ligjin për procedurat penale. Në këtë drejtim janë sjellë dy vepra të reja: 418-b kontrabandimi me migrantë dhe neni 418-c Organizimi dhe nxitja e kryerjes së veprave penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandimi i migrantëve.

Me inkuadrimin e inkriminimit të trafikimit me qenie njerëzore në legjislacionin penal të Republikës së Maqedonisë, gjykatat dhe prokuroritë tona proceduan me sukses një numër të madh të rasteve të paraqitura të veprave penale të trafikimit me qenie njerëzore.

Në funksionin e implementimit të së drejtës së mbrojtjes të identitetit dhe të privatitetit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për procedurat penale të miratuara në tetor të vitit 2004 inkuadrohet edhe kapitulli XIX-a, si kapitull i ri qe lidhet me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe të viktimave. Në përputhje me këto dispozita, përcaktohen masa procedurale dhe jo procedurale për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe të viktimave.

Krahas ndryshimeve dhe plotësimeve në rregullativën juridike penale, në pjesën e legjislacionit është miratuar edhe Ligji për

mbrojtjen e dëshmitarëve, ndërsa në procedurë e sipër është miratimi i Ligjit për kushtet dhe procedurat e përcjelljes së komunikimeve.

Gjatë kohës së veprimit të tij Komisioni nacional i shqyrtonte aktivitetet e ndërmarra në plan legjislativ, në drejtim të modernizimit të masave për përcjelljen dhe luftën efikase kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në drejtim të përparimit të rregulativës ekzistuese penale – procedurale për ndihmë juridike edukuese ndërkombëtare, si edhe për përshpejtimin e procesit të reformave të legjislativës penale në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Formimi i kornizës juridike për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave të aktiviteteve kriminele është me rëndësi të veçantë, madje edhe shumë më tepër se ç`thuhet, sepse në vitin e kaluar në Sarajevë u nënshkrua deklarata e ministrave të punëve të brendshme dhe përfaqësuesve shtetëror të Evropës juglindore për luftën kundër krimit të organizuar, në veçanti lidhur me mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave, si edhe me mbrojtjen e dëshmitarëve. Edhe në Ohër, poashtu, u nënshkruar Deklarata e Adriatikut midis Maqedonisë, Kroacisë dhe Shqipërisë me bashkëngjitje prioritare të Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnjës dhe Hercegovinës, me të cilën shtetet nënshkruese obligohen për një bashkëpunim të përforcuar në shpartallimin e krimit të organizuar, trafikimit të palejuar me armë, narkotikë dhe trafikimit me qenie njerëzore.

Lidhur me çështjen e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, Republika e Maqedonisë po ndërmerr aktivitete për sigurimin e sistemit juridik dhe administrativ, që do të përfshijë masa sigurimi të informatave të viktimave, të procedurave gjegjëse gjyqësore dhe administrative përballë organeve përgjegjëse, ndihmë e cila mundëson qëndrimet e tyre të jenë të paraqitura dhe të shqyrtuara në fazat gjegjëse të procedurave penale kundër kryesve të akteve penale, në atë mënyrë që të mos ndikohet në të drejtën e mbrojtjes. Përveç kësaj, po ndërmerren masa edhe për sigurimin e sistemimit përkatës, për dhënien e këshillave dhe informatave lidhur me të drejtat e tyre ligjore, masa për ndihmë shëndetësore, psikologjike dhe materiale si dhe sigurim fizik të viktimave deri në repatrijimin e tyre përfundimtar.

Efikasiteti në luftën kundër kriminalitetit domosdo kërkon shfrytëzimin e të gjitha mjeteve ekzistuese si edhe metodave, prej atyreve klasike (konvencionale) e deri te ato më të rejat (bashkëkohore). Në realitet, prezantimi i informatave përballë organeve të hetuesisë sjell në rrezik shpeshherë vetë burimin e informatave (dëshmitarin), jetën e tij, shëndetin dhe pronën e tij, si edhe të anëtarëve të familjes së tij. Nevoja për shfrytëzimin e burimit të tillë të informatave i imponon shtetit edhe obligimin që të parashikojë edhe një mekanizëm gjegjës mbrojtës, i cili do të mundësonte siguri për dëshmitarin edhe për më të afërmit e tij.

Edhe pse prej shumë kohësh më parë, në kohën e fundit, në mesin e popullatës, por edhe në mesin e ekspertëve (specialistëve) të kriminalistikës dhe të policisë gjithnjë e më tepër tematizohet çështja e të ashtuquajturit Program për mbrojtjen e dëshmitarëve, që lidhet, në veçanti, me mundësitë që kjo të rregullohet në mënyrë ligjore tek ne.

## 2. Bashkëpunimi ndërkombëtar, rajonal dhe policor

Programi nacional për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë i miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në pjesën e pestë të tij, i cili lidhet me bashkëpunimin dhe me koordinimin ndërkombëtar në implementimin e ligjeve, nënvizon qëllimet themelore strategjike dhe aktivitet e veçanta, si edhe bartësit e aktiviteteve për krijimin e kushteve për bashkëpunim dhe koordinim ndërkombëtar në ndjekjen e kryesve të veprave penale lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore.

Duke e pasur në konsiderim karakterin transnacional të trafikimit me qenie njerëzore, është e domosdoshme edhe një qasje multiagjenciale dhe ndërkombëtare në këmbimin e informatave, të dhënave dhe njohurive në këtë lloj aktivitetesh kriminale, si edhe të masave dhe të aksioneve parandaluese, siç janë: identifikimi dhe mbrojtja e viktimave, mënyra e koordinimit dhe e realizimit të ndjekjes penale.

Me reformat e kryera në Ministrinë e punëve të Brendshme, në suazat e departamentit për krimin e organizuar, është themeluar një Sektor i veçantë për bashkëpunim ndërkombëtar policor në kornizat e së cilës, përveç Byrosë qendrore nacionale të INTERPOL-it, funksionon edhe Zyra nacionale e SEKI Qendrës, ndërsa është parashikuar, që pas krijimit të parakushteve të nevojshme, të bëhet emërtimi edhe i oficerëve për lidhje me EVROPOL-in.

Bashkëpunimi në këtë sektor lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore po zbatohet në më shumë drejtime me qëllim të identifikimit të arsyeve për paraqitjen e trafikimit të qenieve njerëzore, analizës së paraqitjes dhe etablimit (themelimit) të mekanizmit për shpartallimin e tij në nivel rajonal, e gjithashtu edhe në plan ndërkombëtar.

Këmbimi i informatave, njohurive dhe të dhënave midis shteteve që realizohet me qëllim të identifikimit, zbulimit, shpartallimit, arrestimit dhe ndjekjes, gjegjësisht akuzës së personave ose organizatave të inkuadruara në trafikim të qenieve njerëzore si dhe të migrimit ilegal; zbulimit dhe mbylljes së rrugëve gjegjësisht kanaleve dhe rrugëve të trafikimit me qenie njerëzore, kontrabandimit me qenie njerëzore dhe migrimin ilegal; identifikimit të viktimave në këtë lloj aktivitetesh kriminele, të ndihmojë repatriimin e tyre në shtetet e tyre gjegjëse; të ketë përkujdesje adekuate ndaj viktimave, kthimit dhe reintegrimit të tyre, në veçanti, te grupet e rrezikuara, siç janë femrat dhe fëmijët; të bëjë zbulimin dhe sigurimin e dëshmitarëve, tanimë të repatriuar në shtete e tyre amë, të cilët nevojiten për dëshmim para gjykatave gjegjëse në Republikën e Maqedonisë; të ndihmojë realizimin e mundësisë për të dhënë dëshminë nëpërmjet të konferencës me telefon dhe nëpërmjet të videos, si dhe të shqyrtojë mënyrat e operimit (modus operandi) të zbatimit të veprave penale në këtë lëmë.

Në të njëjtën kohë Republika e Maqedonisë mori pjesë edhe në aksionet operative rajonale në këtë fushë, duke u koordinuar nga ana e SEKI Qendrës.

Duhet theksuar edhe praktika e ndërmarrjes së aktiviteteve për zbulimin e shtetaseve të huaja, viktima të trafikimit me qenie njerëzore të cilat janë të repatriuara në shtetet e tyre amë, të nevojshme për dëshmim në procedurat e ngritura penale para gjykatave gjegjëse kundër të akuzuarve për vepra penale në fushën e trafikimit me qenie njerëzore, që realizohet nëpërmjet të SEKI Qendrës[5]. Në pjesën e zbulimit të dëshmitarëve nëpërmjet të SEKI Qendrës është realizuar një bashkëpunim me MPB-të e Rumanisë, Moldavisë, Bullgarisë, Ukrainës si edhe të shteteve të tjera, shtetasit, të cilë nevojiten si dëshmitarë.

Me rëndësi të veçantë për Republikën e Maqedonisë është realizimi i bashkëpunimit nëpërmjet të SEKI Qendrës me Moldavinë në realizimin e dëshmisë nëpërmjet të video konferencës së dëshmitarit nga Moldavia përballë Gjykatës Themelore në Tetovë. Ky është rasti i vetëm në rajonin tonë të mënyrës së tillë të dhënies së dëshmisë nga një dëshmitar prej një shteti tjetër.

Bashkëpunimi rajonal në këtë lëmë është një proces të cilit po i kushtohet një rëndësi e veçantë. Në përputhje me konkludimet e miratuara në mbledhjet e Koordinatorëve nacionalë për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Zagreb, është arritur edhe një konsensus i përgjithshëm se ekzistimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e shpartallimit të trafikimit me qenie njerëzore, duhet të përforcohet vazhdimisht, në veçanti pas përfundimit të mandatit të Grupit punues për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore të Paktit të stabilizimit dhe asociimit.

Si rezultat i vazhdimit të mbështetjes së fortë në zhvillimin profesional të policisë, të prokurorisë publike dhe të gjykatave në Republikën e Maqedonisë, në fushën e ballafaqimit me problemin e trafikimit të qenieve njerëzore Sekretariati, në bashkëpunim me

*5. Vetëm gjatë vitit 2004,në Sektorin për bashkëpunim ndërkombëtar policor për krimin e organizuar në MPB, janë dorëzuar 20 kërkesa për gjetjen e 48 dëshmitarëve – viktimave të trafikimit me qenie njerëzore ose të prostituimit të dhunshëm, të cilët janë repatriuar në shtete e tyre amë, prej të cilëve si rezultat i masave dhe aktiviteteve të ndërmarra, nëpërmjet të SEKI Qendrës në Bukuresht, janë gjetur krejtësisht 15 persona prej dëshmitarëve të kërkuar, prej të cilëve 11 shtetas të jashtëm janë siguruar për dëshmi, që janë dakorduar të japin dëshminë e tyre në kohën dhe vendin e caktuar para gjykatave gjegjëse.*

anëtarët e tij dhe me specialistët nga kjo fushë, punon në implementimin e disa projekteve të programit KARDS që kanë të bëjnë me këtë fushë.

Në kornizat e projektit "Përmirësimi në implementimin e planeve nacionale të aksionit për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore nëpër shtete në procesin e stabilizimit dhe asociimit", projektit të mbështetur financiarisht nga programi rajonal i KARDS-it "Mbështetja e shoqërisë qytetare për zvogëlimin e krimit transkufitar, nëpërmjet të aksioneve rajonale për ndihmë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe iniciativave kundër korrupsionit", në fazën e përgatitjes është edhe plani aksional nacional për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, nga ana e Grupit punues të themeluar për këtë qëllim.

Me aktivitetet e përfshirë në modulin e dytë"Mundësimi trajnimit krahasues në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, kontrabandimit dhe migrimit ilegal" nga Projekti rajonal KARDS për krimin e organizuar »Zhvillimi i sistemeve të sigurta dhe funksionale në aspektin politik si edhe përparimin e luftës kundër aktiviteteve kryesore kriminele dhe bashkëpunimit policor«, do të zhvillohen një program mësimor si dhe kurse për trajnim, me se do të sigurohet informim koherent, i gjithmbarshëm, i azhurnuar, i unifikuar dhe cilësor në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore, kontrabandës dhe migrimit ilegal të tyre.

## 3. Edukimi

Në kornizat e bashkëpunimit, procesi i edukimit dhe i shterrjes së eksperiencave ndërkombëtare për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimit ilegal, anëtarët e Komisionit nacional morën pjesë në punëtorí dhe seminare edhe në atë drejtim me rëndësi të veçantë në realizimin e Projektit për trajnimin dhe mësimin e pjesëtarëve të policisë dhe gjykatave për »vetëdijshmëri për gjininë dhe luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore«, me se ishte paraparë trajnimi me instruktorët për luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore, e cila u operacionalizua në bazë të Memorandumit për bashkëpunim i nënshkruar nga ana e IOM-it, OSBE-së dhe MPB-së.

Theks i veçantë në periudhën e ardhshme do t`i kushtohet institucionalizimit të edukimit dhe të trajnimit në fushën e trafikimit me qenie njerëzore, më saktësisht inkuadrimit të përmbajtjeve gjegjëse lidhur me këtë fenomen në programin mësimor të rregullt të shkollave dhe të institucioneve të arsimit superior.

Edukimi dhe trajnimi duhet të jenë sistematik, t'iu përgjigjen nevojave konkrete (për të cilën duhet kryer edhe një anketim përkatës), me qëllim të jenë të paramenduara mirë dhe të përfaqësojnë një proces të vazhdueshëm, sepse vetëm në atë mënyrë do të mundemi të arrijmë në rezultate të dëshiruara. Programet dhe kurikulumet është e nevojshme të përpilohen dhe të zhvillohen në bazë të qasjes multidisciplinare, gjatë së cilës postulatet fillestare do të bazohen mbi të drejtat e njeriut, barazisë midis gjinive dhe mosdiskriminimit. Programet duhet të jenë të mitatuara pasi që të kalojnë nëpër procedurat gjegjëse edhe nga ana e organeve përkatëse.

Njëra ndër përfitimet e institucionalizimit të përmendur në këtë sferë kaq të rëndësishme të veprimit shoqëror është mundësimi i aktivitetit të koordinuar në këtë plan, i evitimit të dyfishimit të panevojshëm ose përsëritjes së përmbajtjeve të njëjta, madje edhe me grupe qëllimore të njëjta, në llogari të disa subjekteve relevante të cilat aspak nuk janë të inkuadruar ose janë të inkuadruar në mënyrë të pamjaftueshme.

Në këtë fushë dominon, gjithashtu, kuptimi se suksesi i kundërshtisë ndaj trafikimit me qenie njerëzore dhe të migrimit ilegal lidhet me arsimimin e specializuar të grupeve të qëllimit (target grupeve) të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të involvuara në këtë proces. Gjatë kësaj, si grupe qëllimi, duhet të inkuadrohen në veçanti nëpunësit policor, prokurorët publik, gjykatësit, avokatët, personeli i i burgjeve, punëtorët socialë, punëtorët shëndetësorë, punëtorët në arsim, personeli diplomatik – konzular, personat ushtarakë të inkuadruar në misione ushtarake, anëtarë e OJQ-ve, anëtarët e mediave, persona të specializuar të cilët përkujdesen dhe iu japin ndihmë viktimave të trafikimit me qenie njerëzore e tjerë.

Pjesëmarrja e OJQ-ve në këtë fushë, në të ardhmen, duhet të jetë e dimensionuar

në përputhje me kapacitetet të cilat i kanë OJQ-të, më saktësisht me specializimin e tyre, kompetencat dhe trajnimin për të mundur të realizojnë qëllimet e theksuara ose të jenë pjesë e formave tani më të institucionalizuara të edukimit dhe të trajnimit (si faktorë të rëndësishëm në këtë fushë). Në këtë aspekt edhe si pjesë e procedurës për licencimin e tyre për të punuar në fushën e trafikimit me qenie njerëzore do të duhet të verifikohet edhe kapaciteti i tyre për edukim dhe trajnim. Theksi i veprimtarisë së tyre në fushën e edukimit, para së gjithash, do të vendoset në ngritjen e vetëdijes për seriozitetin e këtij fenomeni, për pasojat e dëmshme të cilat mund të rrjedhin prej tij, si dhe mënyrat se si kjo veprimtari të parandalohet.

Në të njëjtën kohë njëri nga prioritetet do të jetë edhe inicimi dhe realizimi i projekteve hulumtuese të lidhura me studimin e këtij ose këtyre fenomeneve. Një fushë e cila deri tani ka qenë e lënë pas dore në mënyrë të paarsyeshme, edhe pse është shumë e rëndësishme, në veçanti në aspekt të fenomenologjisë dhe etimologjisë së saj, e para së gjithash në aspekt të studimit të arsyeve (faktorëve), që e përcaktojnë këtë fenomen me të vërtetë të ndërlikuar, gjegjësisht këtë formë të kriminalitetit. Për këtë qëllim do të duhet të ndahen shumë më tepër mjete dhe do të jetë i nevojshëm një bashkëpunim midis institucioneve të arsimimit superior dhe atyre shkencore – hulumtuese, në nivel nacional dhe më gjerë, por para së gjithash në nivel rajonal.

# QËLLIMET STRATEGJIKE

Gjatë vijimit të punës së tij Komisioni nacional edhe në periudhën e ardhshme dyvjeçare do të përqendrohet në operacionalizimin e qëllimeve strategjike që nuk ishin realizuar në periudhën e kaluar, si edhe në implementimin e qëllimeve të identifikuar me vlerësimin e gjendjes ekzistuese në fushën e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Republikën e Maqedonisë.

Komisioni nacional për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë, në periudhën e ardhshme do të punojë në gjetjen e përgjigjes adekuate ndaj këtij lloji aktivitetesh kriminele nëpërmjet të implementimit të strategjisë, nëpërmjet të verifikimit të parimeve dhe drejtimeve vijuese për veprim në fushën e:

## 1. Kornizës mbështetëse

1.1. Strukturave koordinuese

- Përforcimit të rolit koordinues të Komisionit nacional
- Sekretariatit të Komisionit nacional
- Nëngrupit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve.

1.2. Kornizës ligjore dhe rregullative

- Shkallës më të lartë të harmonizimit të legjislacionit të vendit me standardet ndërkombëtare
- Implementimit të aktiviteteve prioritare prej APEP që e përfshijnë në këtë fenomen
- Ndryshimit të legjislativës kombëtare.

1.3. Ndërtimit të kapaciteteve

Zmadhimit (rritjes) të kapaciteteve të subjekteve shtetërore dhe joqeveritare për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore nëpërmjet të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut.

1.4. Mobilizimit të resurseve dhe të buxhetit

- Sigurimit të resurseve njerëzore dhe materialeve për implementimin e strategjisë dhe planit aksional nacional për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore si dhe migrimit ilegal.

## 2. Parandalimit (preventivës)

2.1. Ngritjes së vetëdijes dhe edukimit

- Ndërtimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe të përhershëm për edukim dhe përngritjen e vetëdijes lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore si dhe me migrimin ilegal.

## 3. Mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave dhe dëshmitarëve

3.1. Identifikimit të viktimës

- Qasjes së standardizuar dhe sigurimit të identifikimit të hershëm të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

3.2. Mbështetjes sociale dhe mbrojtjes së viktimave

- Mbështetjes psiqike – sociale dhe mbrojtjes së viktimave

3.4. Qasjes deri te procedurat juridike, mbrojtjes së dëshmitarëve dhe trajtimit gjyqësor te personave – viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore

- Qasjes së tërësishme deri te organet gjyqësore dhe administrative dhe dhënies së ndihmës profesionale të duhur pa pagesë.

3.5. Reintegrimit, përfshirjes sociale dhe kthimit

- Parandalimit të viktimizimit të përsëritur.

# 4. Ndjekjes (hetimit) dhe ndjekjes penale të trafikimit me qenie njerëzore.

4.1. Hetimit proaktiv dhe retroaktiv.

4.2. Bashkëpunimit ndërkombëtar midis organeve përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe bashkëpunim gjyqësor.

# IMPLEMENTIMI

Rrezikimi i funksioneve thelbësore të jetës shoqërore nga ky kriminalitet, në kushtet bashkëkohore, është i rëndë, i rrezikshëm dhe në nivel shumë të lartë. Nuk ka asnjë shtet i cili nuk po ballafaqohet me dëme të mëdha dhe të papërmirësueshme si rezultat i shtrirjes së gjerë të disa prej formave të tij të paraqitjes. Mosekzistimi i kufijve midis shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, mjetet e sofistikuara të komunikimit, lëvizshmëria dhe fleksibiliteti i theksuar, lidhshmëria e aktiviteteve ligjore me aktivitetet ilegale, gjetja e metodave të reja të veprimit, si dhe karakteri transnacional i krimit të organizuar janë faktorët të cilët iu mundësojnë strukturave kriminele, në veçanti atyre në nivel më të lartë, të cilët merren me trafikimin e qenieve njerëzore, të jenë të pakapshëm për organet e ndjekjes.

Nga e tërë kjo që u theksua më lartë në këtë dokument, si edhe për shkak të faktit se sistemi i realizimit të aktiviteteve kriminele që përfshijnë këtë formë të krimit të organizuar ndryshon, duke kërkuar forma të reja për shtimin e të ardhurave, kërkon përgjigje adekuate nga Qeveria si edhe nga të gjitha subjektet e tjera për parandalimin e këtij fenomeni kriminal ose të zvogëlimit të tij si edhe qëndrueshmërisë në politikën e minimizimit të kësaj forme të paraqitjes së krimit të organizuar.

Suksesi i implementimit do të varet, para së gjithash, prej:

- kapaciteteve institucionale dhe aftësisë së tyre për të udhëhequr dhe për të koordinuar;
- analizës së gjendjes (situatës);
- suksesit në monitorimin e operacionalizimit të qëllimeve strategjike;
- Involvimit më të gjerë të administratës publike nga ana e organeve të drejtorive shtetërore të cilat janë përgjegjëse për luftën kundër këtij lloji të krimit të organizuar;
- qasjes proaktive të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në veçanti në shpërndarjen e mjeteve financiare prej buxhetit për realizimin e aktiviteteve për të cilat nuk do të mund të fitohen mjete nga donatorët ndërkombëtar;
- përmirësimit dhe bashkëpunimit më të qëndrueshëm midis institucioneve qeveritare dhe organizatave ndërkombëtare dhe joqeveritare.

Angazhimi më i madh për operacionalizimin e suksesshëm të qëllimeve strategjike të këtij dokumenti pritet prej organeve të drejtorive shtetërore dhe administratës publike të saj sepse në përgjegjësinë e tyre qëndron parandalimi i kësaj forme të krimit të organizuar. Në këtë drejtim, bashkëpunimi i drejtpërdrejtë dhe mbështetja nga ana e organizatave ndërkombëtare dhe e atyre joqeveritare, gjithashtu, do të ketë rëndësi thelbësore për implementimin e tij.

Nga pikëvështrimi financiar, implementimi i strategjisë së Komisionit nacional do të kushtëzojë implikime të cilat më vonë duhet të përcaktohen, për të korresponduar me aktivitetet e fazave të ndryshme me saktësi të caktuar realizimi.

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
KOMISIONI NACIONALPËR LUFTË KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ
DHE MIGRIMIT ILEGAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

# PLANI AKCIONAL NACIONAL PËR LUFTË KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MIGRIMIT ILEGAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Shkup, mars 2006

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| **1. KORNIZA MBËSHTETËSE** | | | | | |
| **1.1. Strukturat koordinuese** | | | | | |
| Përforcimi i rolit koordinativ të Komisionit Nacional | 1. Bashkëpunim midis të gjitha subjekteve të involvuara në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore në shtet: Institucionet qeveritare, organizatat ndërkombëtare, organizatat Joqeveritare, koordinimi, monitorimi dhe vlerësimi | 1. Koordinimi i aktiviteteve të të gjitha subjekteve të inkuadruara në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore | 1. Koordinatori i Komisionit nacional. | 1. Në kontiniutet | 1. Rritja e efikasitetit në bashkëpunim midis palëve të involvuara në shpartallimin e trafikimit me qenie njerëzore. |
| | | 2. Mbajtja e mbledhjeve tremujore për analizimin e rezultateve të arritura dhe dhënia e orientimeve (drejtimeve) për aktivitetet e mëtutjeshme | 2. Koordinatori i Komisionit nacional | 2. Kuartale | 2. Numri i mbledhjeve të mbajtura dhe konkludimet e nxjerra prej tyre |
| | | 3. Përpilimi i raportit vjetor dhe dorëzimi i tij pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë | 3. Komisioni nacional | 3. Vjetore | 3. Pranimi i raportit nga ana e Qeverisë së RM |
| | | 4. Shqyrtimi i propozimeve nga ana e Sekretariatit të Komisionit nacional dhe i nëngrupit për luftën kundër trafikimit me fëmijë | 4. Komisioni nacional | 4. Në kontiniutet | 4. Numri i propozimeve të pranuara dhe detyrave të realizuara |
| | | 5. Realizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar | 5. Koordinatori dhe anëtarët e Komisionit nacional | 5. Në kontiniutet | 5. Aktivitetet e realizuara në planin ndërkombëtar |
| Sekretariati i Komisionit Nacional | 1. Sigurimi i informatave dhe aktiviteteve të OJQ- | 1. a) Përpilimi i listës së anëtarëve të Sekretariatit | 1. a) Sekretari | 1. a) Gjatë vitit 2006 | 1. a) Ezkistimi i listës |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | ve dhe organizatave qeveritare dhe ndërkombëtare të cilat janë të involvuara në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore në shtet. | 1. b) Mbajtja e mbledhjeve | 1. b) Sekretari | 1.b) në kontinuitet | 1. b) Numri i mbledhjeve të mbajtura dhe përpilimi i adresarit |
| | | 1. c) Përpilimi dhe azhurnimi i rregullt i adresarit (informatorit) të organizatave qeveritare, joqeveritare dhe ndërkombëtare | 1. c) Sekretari | 1.c) në kontinuitet | 1. c) Numri i mbledhjeve të mbajtura dhe përpilimi i adresarit |
| Sekretariati i Komisionit Nacional | 2. Shqyrtimi i aktiviteteve të plota të implementuara nga Sekretariati | 2. a) Informimi i rregullt i Komisionit nacional për aktivitetet e ndërmarra nga anëtarët e Sekretariatit | 2.a) Sekretari | 2.a) në kontinuitet | 2. a) Qarkullimi i informatave |
| | | 2. b) Rrjetëzimi i anëtarëve të Sekretariatit me qëllim të këmbimit të informatave | 2. b) Sekretari | 2. b) në vitin 2006 | 2. b) Ekzistimi i sistemit elektronik për qarkullimin dhe këmbimin e informatave |
| | 3. Kriteret për anëtarët e rinj të Sekretariatit | 3. Përgatitja e propozim kritereve | 3. a) Sekretari | 3. a) në vitin 2006 | 3. a) Ekzistimi i rregullores |
| Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë | 1. Miratimi i propozim planit për luftën kundër trafikimit me fëmijë | 1. Implementimi i Planit aksional për luftën kundër trafikimit me fëmijë | 1. Kryesues i nëngrupit | 1. në vitin 2006 | 1. Analiza dhe përgatitja e raportit për shkallën e suksesit të implementimit të aktiviteteve |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| **1.2. Korniza ligjore dhe rregullative** | | | | | |
| | 1. Shkallë më e lartë e harmonizimit të legjislacionit të vendit me standarde ndërkombëtare | 1.a) Azhurimi i rregullt dhe propozimi i planeve dhe implementimi i akteve të nënshkruara dhe të ratifikuara | 1. a) Qeveria e RM | 1.a) viti 2006 -2007 | 1.a) Numri i marrëveshjeve të ratifikuara dhe të nënshkruara |
| | | 1. b) Nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale në ndihmën për të drejtën ndërkombëtare; bashkëpunimin rajonal dhe ekstradimin | 1.б) Qeveria e RM/ MPB | 1. b) viti 2006 dhe në kontinuitet | 1. b) Numri i marrëveshjeve të ratifikuara dhe të nënshkruara |
| | | 1. c) Miratimi, nënshkrimi dhe ratifikimi i Konventës për bashkëpunim policor | 1. c) MPB e RM | 1. c) viti 2006 dhe në kontinuitet | 1. c) Shkalla e aplikueshmërisë |
| | 2. Implementimi i AP prej EP | 2. a) Miratimi i ligjit për ndjekjen e komunikimeve | | | 2. a) Numri i rasteve të zbatuara (para dhe pas miratimit) |
| | 3. Ndryshimi i legjislacionit nacional | 3. a) Harmonizimi i legjislacionit penal në funksion të luftës efikase kundër krimit të organizuar; 3.b) Ndryshimi i dispozitave ligjore për rregullimin e statusit për qëndrim të përkohshëm në Ligjin për lëvizjen dhe qëndrimin e shtetasve të huaj; 3.c) Ndryshimi dhe plotësimi i | | Viti 2007-2008 | 3. d) Përmirësimi i punës lidhur me luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore midis të gjithë sektorëve të inkuadruar;<br>3. e) Numri i rasteve të realizuara<br>- udhëheqje më e mirë ditore dhe koordinimi i |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Ligjit për procedurën penale në pjesën e masave të vlerësuara për mbrojtjen e dëshmitarëve;<br>3.d) Definimi i kompetencave të sektorëve vijues në MPB për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore: policia kufitare, departamenti për krimin e organizuar, Departamenti për të huaj dhe policia lokale;<br>3. e) Të përcaktohet departamenti për krimin e organizuar si trup udhëheqës në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore;<br>3. f ) Të themelohet njësia udhëheqëse në Qendrën e tranzitimit dhe të përpilohen aktet nënligjore lidhur me të njëjtën;<br>3g) Të përpilohen aktet nënligjore me qëllim të rregullimit të të gjithë aspekteve relevant gjatë procedurimit me viktimat; | | | përmirësuar midis të gjithë sektorëve në Ministrinë e Punëve të Brendshme të inkuadruara në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore;<br>- numri i hetimeve proaktive;<br>- ndarje më e mirë e punëve midis personave të autorizuar prej sektorëve të ndryshëm relevant pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme;<br>- shkalla e efikasitetit në MPB në fushën gjegjëse të veprimit;<br>- udhëheqje më e mirë e Qendrës së tranzitimit; |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| **1.3. Ndërtimi i kapaciteteve** | | | | | |
| Rritja e kapaciteteve të subjekteve shtetërore dhe joshtetërore për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore nëpërmjet të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut | 1. Krijimi i politikës së përpilimit dhe implementimit të trajnimeve edukative | 1. a) Inkuadrimi në programin e rregullt të edukimit të dëgjuesve në Akademinë policore dhe në institucionet e tjera të larta edukative lidhur me temën e trafikimit me qenie njerëzore | 1. a) Ministria e arsimit dhe MPB, Akademia policore | 1. a) viti 2006 | 1. a) Rritja e numrit të personave të inkuadruar |
| | | 1. b) Trajnim i përgjithshëm dhe i specializuar për pjesëtarët e organeve kompetente për zbatimin e ligjit si edhe për gazetarë, OJQ, personelin diplomatik | 1. b) Trajnerë të ushtruar | 1. b) viti 2006 | 1. b) Numri i personave të trajnuar |
| | | 1. c) Definimi i grupeve të qëllimit për organizimin dhe implementimin e trajnimeve | 1. c) MPB, Akademia policore dhe organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të | 1. c) viti 2006 | |
| | 2. Mbështetja e kapacitetit të linjës ekzistuese SOS për ndihmën e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore | 2. Edukimi i vazhdueshëm i 9 operatorëve dhe sigurimi i funksionimit të vazhdueshëm të linjës | 2. Qeveria e RM, sektori i OJQ-ve – bartës i SOS linjës, organizatat ndërkombëtare | | 2. Fushatat e realizuara me sukses kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe rastet e parandaluara |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | 3. Përforcimi i kapaciteteve të vendeve ekzistuese për pranimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore prej Maqedonie | 3. Trajnim i vazhdueshëm | 3. Qeveria e RM dhe bartësi i projektit, MPPS dhe OJQ | 3. viti 2007 dhe në kontinuitet | 3. Rritja e aktiviteteve në vendet e tilla të pranimit dhe hetimit të realizuara lidhur me emigrimin e vendit |
| **1.4. Menaxhimi i informatave dhe i hulumtimeve** | | | | | |
| | 1. Hulumtimi i pandërprerë i fenomenit | 1. a) Zbatimi i hulumtimeve dhe i analizave në fushën e trafikimit me qenie njerëzore | 1. a) Zyra e Komisionit nacional, OJQ, organizatat ndërkombëtare, Akademia policore dhe institucionet gjegjëse | 1. a) viti 2006 dhe në kontinuitet | 1. a) Numri i hulumtimeve dhe analizave të kryera |
| | 2. Rregulli i qasjes deri tek të dhënat lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore dhe këmbimi i tyre | 2. a) Këmbimi i të dhënave në nivel nacional, rajonal dhe ndërkombëtar | 2. a) Komisioni nacional, OJQ, organizatat ndërkombëtare | 2. a) viti 2006 dhe më tutje në kontinuitet | |
| | | 2. b) Përgatitja e raporteve për popullatën | 2. c) Komisioni nacional | 2. b) Vjetor | 2. b) Numri i analizave dhe raporteve të kryera |
| | | 2. c) Krijimi i ueb faqes të Komisionit nacional | 2. d) Sekretariati | 2. c) viti 2006 | 2. c) Krijohet ueb faqja e azhuruar |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 2. d) Emërtimi i raportuesit nacional | 2. e) Komisioni nacional | 2. d) viti 2006 | 2. d) Përgatitet analiza |
| | 3. Krijimi i SOFTUER-i për të dhënat në fushën e trafikimit me qenie njerëzore | 3. a) Futja dhe përpunimi i të dhënave | 3. a) MPB dhe OJQ | 3.a) në kontinuitet | 3. a) Funksionimi i suksesshëm i bazës së të dhënave dhe sigurimi i të dhënave statistikore |
| | | 3.b) Të dhëna prej/ për aktivitetet e OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare dhe prej implementimit të projekteve | 3. б) OJQ, Komisioni nacional dhe organizatat ndërkombëtare | 3.b) në kontinuitet | |
| **1.5 Mobilizimi i resurseve dhe buxhetit** | | | | | |
| Sigurimi i resurseve njerëzore dhe materiale për implementimin e APN dhe STR | 1. Sigurimi i parakushteve institucionale për funksionimin e komisionit | 1. a) Pasqyrë e të gjitha nevojave materiale, teknike dhe financiare | 1. a) Komisioni nacional | 1. a) viti 2006 | 1. a) Linja të vendosura adekuate buxhetore për mbështetjen e resurseve njerëzore dhe materiale |
| | | 1. b) Përpilimi dhe miratimi i buxhetit të veçantë për nevojat e komisionit | 1. b) Komisioni nacional dhe Qeveria e RM-së | 1. b) viti 2006 | 1. b) Linja të vendosura adekuate buxhetore për mbështetjen e resurseve njerëzore dhe materiale |
| | | 1. c) Grumbullimi i mjeteve financiare | 1. c) Komisioni nacional | 1.c) në kontinuitet | 1. c) Linja të vendosura adekuate buxhetore për mbështetjen e resurseve njerëzore dhe materiale |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 1. d) Punësimi i kuadrit profesional | 1. d) Qeveria e RM dhe Komisioni nacional | 1. d) viti 2006 | 1. d) Kuadër profesional në kryerjen e aktiviteteve të lartpërmendura me përshkrim të saktë të detyrave të punës |
| | | 1. e) Sigurimi i zyrës së Komisionit nacional (Sekretariati dhe nëngrupi) | 1. e) Qeveria e RM | 1. e) viti 2006 | |
| | | 1. f) Përpilimi i resurs planit nacional | 1. f) Komisioni nacional | 1. f) viti 2006 | 1. e) Efikasitet i rritur i koordinitetit të Komisionit nacional |
| | | 1. g) Sigurimi i donatorëve | 1. g) Komisioni nacional | 1. g) viti 2006 | |
| **1.6. Hulumtimi, monitorimi dhe vlerësimi** | | | | | |
| | Avancim i vazhdueshëm i përgjigjes Nacionale ndaj trafikimit me qenie njerëzore | 1. Përpilimi i planit të gjithmbarshëm për hulumtim, monitorim dhe vlerësim | 1. Komisioni nacional | 1.Fund i vitit 2006 | 1. Shqyrtim i gjithmbarshëm dhe i azhuruar dhe pasqyrë e gjendjes (në çdo kohë) |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| **2. PARANDALIMI (PREVENTIVA)** | | | | | |
| **2.1. Ngritja e vetëdijes dhe edukimi** | | | | | |
| Ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të përhershëm për edukim dhe ngritjen e vetëdijes lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore dhe migrimin ilegal | 1. Kapacitet i zmadhuar i sektorit të OJQ të inkuadruar në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimin ilegal | 1. a) Trajnimi/ritrajnimi i OJQ-ve për trendet e reja | 1.a) b) Institucione qeveritare, organizata ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare, OJQ të specializuara, institucione të arsimit superior | 1) a) b) prej vitit 2006 | 1.a) b) Rritja e numrit të OJQ-ve të trajnuara;<br>1. a) b) Përfshierje e plotë teritoriale |
| | | 1. b) Inkuadrimi i OJQ-ve në fushatat për ngritjen e vetëdijes | | | |
| | 2. Rritja e vetëdijes të "grupeve të rrezikut" ndaj rreziqeve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore | 2. a) Njohja e "grupeve të rrezikut" | 2. a) b) MPB-ja, Ministria e Punës dhe çështjeve sociale, Ministria e arsimit dhe institucionet e arsimimit superior dhe organizatat joqeveritare | 2. a) b) në kontinuitet | 2. Grupe të reja të identifikuara të rrezikut - rritja e vetëdijes të grupeve të caktuara të rrezikut – numri i zvogëluar i viktimave që dalin nga grupet e ndryshme të rrezikut |
| | | 2. b) Organizimi i fushatave në përputhje me nevojat e grupeve të caktuara të rrezikut | | | |
| | 3. Rritja e vetëdijes të shfrytëzuesve dhe shfrytëzuesve potencial të shër-bimeve seksuale prej viktimave të trafikimit me qenie njerëzore | 3. a) Fushata për ndikimi mbi vetëdijen dhe shpërndarja e materialit gjegjës propagues tek shfrytëzuesit dhe shfrytëzuesit potencial | 3. a) Organi për zbatimin e ligjit, OJQ-të | 3.a) në kontinuitet | 3.a) Përfshirja e zmadhuar e shfrytëzuesve dhe shfrytëzuesve potencial në fushatat – përpilimi i materialeve adekuate propaguese |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | 4. Rritja e vetëdijes së organeve kompetente shtetërore për trafikimin e qenieve njerëzore dhe migrimet ilegale | 4. a) Dezenimi i trajnimit gjegjës të organeve të ndryshme kompetente në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimet ilegale | 4. a) Ministritë gjegjëse në koordinim me Komisionin nacional dhe institucionet gjegjëse arsimore | 4. a) viti 2006 | 4.a) Numri i zmadhuar i veprave të zbuluara dhe të proceduara të trafikimit me qenie njerëzore |
| | | 4. b) Shfrytëzimi i rezultateve prej projekteve të ndryshme rajonale të cilat e trajtojnë këtë lëmë nëpërmjet të trajnimeve të gjithmbarshme që si shtesë janë akomoduar për struktura të ndryshme | 4. b) Sekratariati i cili ka pasqyrë dhe i koordinon projektet e tilla, Ministria e arsimit dhe institucionet gjegjëse | | 4. b) Ekzistimi i përmbajtjeve gjegjëse edukative |
| **2.2. Zvogëlimi i lëndueshmërisë** | | | | | |
| | 1. Parandalimi i të gjitha formave të diskriminimit, në veçanti tek grupet e rrezikut | 1.a) Promovimi i fushatës për barazi gjinore | 1. a) MPPS dhe OJQ-të | 1. a) viti 2006 | 1.a) b) Rritja e numrit të femrave të punësuara |
| | | 1. b) Fushata për çrrënjëzimin e të gjitha formave të diskriminimit | 1. b) MPPS dhe OJQ-të | 1. b) viti 2006 | 1. c) Identifikimi i përmirësuar i formave dhe rasteve të diskriminimit |
| | | 1. c) Lehtësimi i qasjes deri te tregu i punës (punësim, rikualifikim, kualifikim shtesë) | 1. c) MPPS dhe OJQ-të | 1. c) kontinuitet prej vitit 2006 | |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | 3. Rritja e mundësive për migrim legal; ndihmë psiko–sociale informative të emigrantëve nga ana e organizatave profesionale ndërkombëtare | 3. a) Institucionalizimi i funksioneve të Qendrës informative të migrimit (QIM) | 3. a) MPJ, MPB, IOM, Organizata joqeveritare | | 3. a) Zvogëlimi i migrimit ilegal dhe pasojave prej tij |
| | | 3. b) Përforcimi i kapaciteteve të departamentit gjegjës në Ministrinë e punëve të jashtme lidhur me informatat për migrimin ilegal | 3. b) MPJ, MPB, IOM dhe Organizata joqeveritare | | 3. b) Zvogëlimi i migrimit ilegal dhe pasojave prej tij |
| | | 3. c) Qasja në informatat për migrimin ilegal deri te popullata e gjerë (linjë informative e organizatave joqeveritare) | 3. c) MPJ, MPB, IOM dhe Organizata joqeveritare | | 3. c) Zvogëlimi i migrimit ilegal dhe pasojave prej tij |
| **2.3. Kontrollat administrative** | | | | | |
| Sisteme të azhuruara të kontrollit shtetëror dhe të inspekcioneve | 1. Rregullimi i monitorimit në sektorët në shoqëri të cilët mund të jenë të lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore | 1. a) Standardizimi i formave të kontrollit dhe rregullimi i proceseve të licencimit | Ministria e punës dhe e politikës sociale, Ministria e Punëve të Brendshme dhe vetëqeverisja lokale | | 1. a) Ekzistimi i rregullativës gjegjëse ligjore |
| | | 1. b) Intensifikimi i bashkëpunimit dhe koordinimit midis organeve të administratës shtetërore | | | 1. b) Ekzistimi i sistemeve të licencuara të agjencioneve për martesa, punësime, turizëm dhe shoqërim (eskort) |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 1. c) Sjellja e protokolleve për bashkëpunim në bazë të Memorandumit të nënshkruar për bashkëpunim midis institucioneve përkatëse | | | 1. c) Numri i protokolleve të sjellura (adoptuara) |
| | 2. Përforcimi i koordinimit të kontrollit administrativ në nivel konzular dhe përforcimi i kontrollit shtetëror | 2.a) Formimi i bazës së të dhënave të dokumenteve të falsifikuara të keqpërdorura në hyrje/dalje | 2. a) MPJ (PDK), MPB dhe Drejtoria e doganave | | 2. a) Numri i dokumenteve të zbuluara të falsifikuara – numri i vizave të refuzuara për arsye të dyshimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore |
| | | 2.b) Monitorimi i implemtnimit të planeve aksionale të tjera rrjedhëse dhe të planifikuar, rekomandime rajonale të mirattuara (KARDS) | 2.b) MPJ (PDK), MPB dhe Drejtoria e doganave | | 2. b) Numri i personave të trajnuar që punojnë në shërbimet kufitare |
| | 3. Identifikim më efikas i viktimave dhe kryerësve të veprave penale - trafikimin e qenieve njerëzore – në vendet kufitare | 3.a) Trajnimi i policisë kufitare dhe implementimi i dorracakëve ekzistues për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimin ilegal si edhe azhurimin e tyre | 3. a) Komisioni nacional, Akademia policore, OJQ dhe organizata ndërkombëtare | 3.a) në kontinuitet | 3.a) b) numri i trajnimeve të mbajtura. Kapshmëria e dorracakëve deri te dëgjuesit dhe adaptimi i tyre sipas grupeve të qëllimit |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 3. b) Vazhdimi i praktikës së plotësimit të pyetësorëve për identifikimin e viktimave potenciale të trafikimit me qenie njerëzore në të gjitha kalimet kufitare. | 3.b) MPB | 3. b) në kontinuitet | 3.a) b) Numri i rritur i pengimeve të hyrjeve ilegale dhe rasteve të proceduara |
| | | 3. c) Intensifikimi i bashkëpunimit bilateral dhe këmbimit të informatave me shërbimet gjegjëse në shtetet e Bashkimit Evropian | | 3.c) në kontinuitet | 3.a) b) c) numri i personave viktima të trafikimit me qenie njerëzore të identifikuar në kufi |
| | | | | | 3.a) b) c) numri i trafikantëve me qenie njerëzore të arrestuar në kufi |
| | | | | | 3.a) b) c) numri i viktimave të zbuluara me masat hetuese proaktive - numri i zmadhuar i marrëveshjeve bilaterale dhe bashkëpunimi në këtë plan |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| **2.4 Identifikimi i shkaqeve dhe i pasojave për trafikim me qenie njerëzore dhe hulumtimi i fenomenit në përgjithësi në nivel të R. Së Maqedonisë** | | | | | |
| | 1. Zmadhimi i aktiviteteve hulumtuese i aspekteve në këtë fushë të luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore | 1.a) Analiza e gjendjes, të dhënat dhe raportet për trafikim me qenie njerëzore. | 1.a) Komisioni nacional, Ministria e arsimit, OJQ dhe institucionet kompetente | 1.a) b) në kontinuitet | 1.a) Numri i hetimeve të realizuara |
| | | 1.b) Realizimi i bashkëpunimit me qendrat përkatëse hulumtuese të rajonit | 1.b) Komisioni nacional, MA, OJQ dhe institucionet përkatëse kompetente | 1. a) b) në kontinuitet | 1.b) Numri i hulumtimeve të realizuara |
| **3. MBËSHTETJA DHE MBROJTJA E VIKTIMAVE DHE DËSHMITARËVE** | | | | | |
| **3.1. Identifikimi i viktimës** | | | | | |
| Qasje e standardizuar dhe sigurimi i identifikimit të hershëm të viktimave të luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore | 1. Definimi i nocionit-viktimë | | 1. a) MD | 1.a) viti 2006 | |
| | 2. Implemntimi i mekanizmit nacional për udhëzimin e viktimave të zbuluara | 2. Drejtimi, mbrojtja dhe ndihma e viktimave në pajtim me standardet ekzistuese | 2. Ministria e punës dhe politikës sociale, OJQ, IOM, MPB, Komisioni nacional | 2.a) viti 2006 | |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | 2.a) Zhvillimi i bashkëpunimit të ndërsjellë midis institucioneve kompetente për zbulim, procedurim dhe sanksionim të kryesve të veprave penale në lëmë të luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore | 2.a) Përparimi i bashkëpunimit midis MPB dhe Departamentit për ndjekjen e kryesve të veprave penale në fushën e krimit të organizuar nga ana e Prokurorisë publike | | | |
| | 3. Praktikë e standardizuar për këmbimin e informatave midis aktorëve relevant gjatë identifikimit të viktimave | 3. Institucionalizimi dhe rregullimi juridik i praktikës ekzistuese pozitive në Qendrën e tranzitimit të MPB/IOM-it në procedurat standarde operative | | | 3. Ekzistimi i numrit më të madh të OJQ-ve të trajnuara për dhënien e ndihmës dhe asistencës për viktimat |
| | | 3.a) Standardizimi i pyetësorit gjatë identifikimit | 3.a) Qendra për punë sociale, OJQ dhe Komisioni nacional | 3.a) viti 2006 | |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | 4. Komunikim i rregullt me të gjitha institucionet, ambasadat dhe përfaqësitë konzulare, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të – ndjekja e rasteve dhe dënimeve të plotfuqishme për trafikimin me qenie njerëzore | | | | |
| | 4. a) Avancimi i kritereve për inkuadrimin e OJQ-ve në sektorin e punës me viktimat dhe dhënia e ndihmës për të njëjtat | 4.a) Komisioni nacional, Sekretariati dhe organizatat ndërkombëtare | | 4.a) viti 2006 | |
| | | 4. b) Përpilimi i listave të OJQ-ve të cilat i mbushin kriteret e lartëpërmendura | 4.b) Sekretariati dhe OJQ-të | 4.b) viti 2006 | |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 4. c) Mbindërtimi i vazhdueshëm i resurseve njerëzore në sektorin e OJQ-ve të cilat veprojnë në fushën e dhënies së ndihmës për viktimat | 4.c) OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare | 4.c) 2006 | |
| **3.2. Periudhe e mendimit/ stabilizimit dhe statusi i qëndrimit** | | | | | |
| | 1. Aprovimi i dispozitave ligjore për qëndrimin e përkohshëm për të gjithë personat (që mendohen të jenë) viktima të trafikimit me qenie njerëzore në vendin tonë, pa marrë parasysh vullnetin e tyre për bashkëpunim me organit në procedurën penale | 1. Përpilimi i teksteve ligjore për reflektimin më adekuat të standardeve ndërkombëtare nga ana e ekipeve përkatëse të përziera | 1. Grupet përkatëse të formuara prej Komisionit nacional dhe Sekretariatit | 1. viti 2006 | 1. Numri i zmadhuar i personave të cilëve ju është dhënë periudhë kohore për tu menduar në krahasim me numrin e personave të asistuar viktima të trafikimit me qenie njerëzore<br>– Numri i zmadhuar i personave të cilëve ju është dhënë qëndrim i përkohshëm në krahasim me numrin e personave të asistuar viktima të trafikimit me qenie njerëzore<br>– shpërndarja e broshurave të dedikuara për personat të cilëve ju është aprovuar qëndrimi |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | i përkohshëm për njohjen e statusit të tyre, të drejtave dhe obligimeve<br>– Numri i personave (që mund të jenë) viktima të luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore, të cilët janë përkujdesur në mënyrat adekuate |
| | **3.** Dhënia e ndihmës së nevojshme si edhe e ndihmës psiko-sociale në vendet e pranimit për viktima të trafikimit me qenie njerëzore nga ana e institucioneve qeveritare dhe OJQ-ve | | | 3. në kontinuitet | |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | 4. Definimi i statusit dhe i rolit të Qendrës së tranzitimit, lidhur me periudhën e stabilizimit dhe qëndrimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore | | 4. MPB, MPPS dhe MPJ | 4. viti 2006 | |
| **3.3. Mbështetja sociale dhe mbrojtja e viktimave** | | | | | |
| Mbështetja psiko - sociale dhe mbrojtja e viktimave | 1. Sigurimi i parakushteve buxhetore dhe kornizë adekuate juridike, bazuar mbi obligimet e shtetit për ndihmën sociale, psikologjike dhe juridike të viktimave | 1. Ndryshime dhe plotësime në tekstet ligjore lidhur me kategorinë e shfrytëzuesve të ndihmës së tillë dhe përkujdesimin të viktima të trafikimit me qenie njerëzore | 1. Komisioni Nacional, Sekretariati dhe grupet punuese në bazë të disa ligjeve, OJQ-ve që tani më punojnë në Qendrën e tranzitimit | 1. vitet 2006-2007 | - Numri i viktimave që u është mundësuar ndihmë në pajtim me standardet ndërkombëtare të pranuara; pjesëmarrja e tyre në procedura; mbrojtja përkatëse dhe socializimi efikas |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | 2. Sigurimi i mbrojtjes fizike për të gjitha viktimat të trafikimit me qenie njerëzore dhe vendosja e tyre në institucione përkatëse | | | | 2. Qendra e tranzitimit si praksë më e mirë e institucionalizuar në tekstet ligjore; mbrojtja e zmadhuar e viktimave |
| | 3. Qasje e standardizuar për sigurimin e rregullave të informimit të viktimave lidhur me të drejtat e tyre, obligimet, opsionet dhe mundësitë | 3. Aprovimi i procedurave operative standarde lidhur me ndihmën e viktimës në nivel të dispozitave ligjore | | 3. viti 2006 | 3. OJQ të trajnuara për dhënien e ndihmës në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare - Numri i materialeve cilësore të përgatitur për të drejtat e viktimave të trafikimit. |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| **3.4. Qasje deri te procedurat juridike, mbrojtja e dëshmitarëve dhe trajtimi gjyqësor i personave viktima të trafikimit me qenie njerëzore** | | | | | |
| Qasje e plotë deri te organet gjyqësore dhe administrative për dhënien e shërbimeve përkatëse profesionale pa pagesë | 1. Sigurimi i implementimit të sistemit special për mbrojtjen e dëshmitarëve për personat – viktima të trafikimit me qenie njerëzore | 1. Vendosja e sistemit të ndihmës juridike në qendrën e tranzitimit dhe formalizimi i qasjes së avokateve femra deri te viktimat e përkujdesur në qendrën e tranzitimit | 1. MPB, OJQ dhe avokatet femra | | 1. Ekzistimi i sistemit special për mbrojtjen e dëshmitarëve të personave – viktima të trafikimit me qenie njerëzore; - numri i personave – viktima të trafikimit me qenie njerëzore, të cilët janë përfshirë me sistemin e mbrojtjes së dëshmitarëve; - numri i personave të inkuadruar në sistemin e mbrojtjes së viktimave – dëshmitarë të inkuadruar në trajnime përkatëse; |
| | 2. Dëmshpërblimi i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në procedurat kundër krimit të organizuar | 2. Trajnim përkatës për shërbimet e sigurimit të dëshmitarëve. Trajnim adekuat i OJQ-ve, avokateve femra dhe organeve gjyqësore lidhur me dëmshpërblimin (neni 101 i LPP-së) | 2. MPB, MD dhe Akademia policore | | 2. Ekzistimi i materialit informativ për viktimat – dëshmitarët (në çfarë rreziku eksponohen nëse vendosin të dëshmojnë, kush do t`i mbrojë, cilat janë të drejtat e tyre etj.) |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| **3.5. Reintegrimi, inkuadrimi social, kthimi** | | | | | |
| Parandalimi i viktimizimit të sërishëm | 1. Sistematizimi i të dhënave për repatriimin vullnetar të trafikimit me qenie njerëzore | 1. Përpilimi i udhëzimeve për veprim | 1. MPPS, Ministria e arsimit dhe OJQ-të | | 1. Ekzistimi i vlerësimit individual i rrezikut për secilën viktimë të trafikimit me qenie njerëzore |
| | 2. Reintegrimi dhe inkuadrimi social i personave-viktima të trafikimit me qenie njerëzore | 2. Përpilimi i programit të reintegrimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, shtetas të Republikës së Maqedonisë – Dhënie prioriteti për punësim të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore , nëpërmjet të programeve të reintegrimit | | | 2. Përqindja e personave viktima të trafikimit me qenie njerëzore të cilët janë të punësuar një vit pas reintegrimit të tyre – Përqindja e personave viktima të trafikimit me qenie njerëzore të cilët kanë rrjet funksionues social një vit pas reintegrimit të tyre |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| **4. HETIMI DHE NDJEKJA PENALE E TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE** | | | | | |
| **4.1 Hetimi proaktiv dhe retroaktiv** | | | | | |
| | 1. Dhënia e prioriteteve për aplikimin e hetimeve proaktive | 1. a) Trajnim për aplikimin e masave të veçanta të hetimit | 1. a) MPB, institucionet kompetente arsimore dhe Ministria e arsimit | | 1.a) Numri i trajnimeve të realizuara – Numri i personave zyrtar të organeve kompetente të përfshirë me trajnimet |
| | | 1. b) Vendosja e bazës operative e të dhënave të trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimi ilegal | 1. b) Komisioni nacional, MPB | | 1.b) Numri i informatave të fituara lidhur me trafikimin me qenie njerëzore dhe migrimit ilegal |
| | | 1. c) Vendosja e softuer-it operativ për udhëheqje me hetimet për trafikimin me qenie njerëzore dhe migrimin ilegal | | | 1. c) Numri i zmadhuar i hetimeve të zbatuara policore |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| **4.2. Bashkëpunimi ndërkombëtar midis organeve gjegjëse për aplikimin e ligjeve (gjegjësisht, bashkëpunimin kriminalistik ndërkombëtar) dhe bashkëpunim gjyqësore** | | | | | |
| | 1. Përforcimi i kapaciteteve ekzistuese dhe ndërtimi i kapaciteteve të tjera të reja institucionale për bashkëpunim ndërkombëtar gjyqësor dhe policor | 1.a) Zhvillimi dhe bashkëpunimi më i mirë midis Zyrave qëndrore nacionale të INTERPOL-it | 1. MPB, MPJ dhe MD | | 1.a) Efikasitet i zmadhuar në bashkëpunimin ndërkombëtar |
| | | 1. b) Përparimi i bashkëpunimit me SEKI Qendrën për luftën kundër krimit ndërkufitar dhe zhvillimi i saj në pajtim me strategjinë e re të aprovuar në mbledhje e 20-të të Komitetit të përbashkët për bashkëpunim | | | 1.b) Efikasitet i zmadhuar në bashkëpunimin ndërkombëtar – Vendosja e bashkëpunimit të koordinuar e institucioneve kompetente në RM me institucionet dhe organizatat si dhe iniciativat |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 1.c) Nënshkrimi i marrëveshjes strategjike, si edhe operative me EVROPOL-in | | | 1.c) Nënshkrimi i marrëveshjes me EVROPOL-in |
| | | 1.d) Zhvillimi, përparimi i bashkëpunimit dhe i komunikimit midis organeve gjyqësore dhe prokurorive publike | | | 1.d) Efikasitet i zmadhuar në bashkëpunimin ndërkombëtar; Vendosja e bashkëpunimit të koordinuar e institucioneve kompetente në RM me institucionet rajonale dhe ndërkombëtare, organizata dhe iniciativa |
| | | 1.e) Intensifikimi i aktiviteteve të pikave-vatra të përcaktuara dhe oficerëve për lidhje në kornizat e më shumë organizatave ndërkombëtare, gjegjësisht nominimi i personave në këto pozita në kuadër të organizatave, atje ku ende nuk është bërë kjo. | | | 1.e) Emërtimi i oficerëve për lidhje |
| | | 1.f) Trajnim i përgjithshëm dhe special në pjesën e bashkëpunimit ndërkombëtar | | | |
| | 2. Aktivitete operative në planin rajonal si edhe në nivel ndërkombëtar | | **2.** MPB, partnerët, MPJ, MD dhe Komisioni nacional | | 2. Modernizimi i këmbimit të të dhënave me shtete e tjera |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | | - Koordinimi dhe pjesëmarrja në aksione operative rajonale në këtë fushë | | | 2. Përgatitja dhe prezantimi i pyetësorëve të standardizuar rajonal për kryerjen e bisedës me viktimën e trafikimit me qenie njerëzore dhe analiza e të dhënave të fituara në nivel rajonal dhe ndërkombëtar me qëllim të zhvillimit dhe implementimit të përgjigjes së gjithmbarshme nacionale kundër trafikimit me qenie njerëzore.<br>- Zbulimi i rrugëve, gjegjësisht i kanaleve dhe ruteve për trafikim, kontrabandimi me njerëz dhe migrim ilegal;<br>- Identifikimi i grupeve dhe individëve ndërkombëtare kriminele dhe ndjekja e tyre penale; - Identifikimi, kujdesimi përkatës, kthimi dhe reintegrimi i viktimave, në veçanti grupeve të rrezikut, siç janë femrat dhe fëmijët. |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgim dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | (2) – Gjetja dhe sigurimi i dëshmitarëve tani më të repatriuar në shtetet e tyre amë të cilët janë të nevojshëm për dëshmim para gjykatave gjegjëse në RM;<br>- Realizimi i mundësisë për të dëgjuar dëshminë nëpërmjet të konferencës telefonike ose video konferencës;<br>- Shqyrtimi i mënyrës së veprimit në zbatimin e veprave kriminale (penale) në këtë lëmë |
| | 3. Aktivitete ligjore në pjesën e bashkëpunimit ndërkombëtar | 3. Nënshkrimi, ratifikimi dhe implementimi i konventave ndërkombëtare të ratifikuara dhe nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale | | | 3. Numri i aksioneve të përbashkëta rajonale ose bilaterale – Numri i hetimeve të përbashkëta me organet përgjegjëse për aplikimin e ligjeve në shtetet e tjera; - Ekzistimi i ekipeve të përbashkëta të hetimit; |

| Qëllimet strategjike | Qëllimet dhe detyrat specifike | Aktivitet /Nën- aktivitete | Përgjegjësitë e dhëna | Korniza kohore | Kritere për vëzhgimi dhe vlerësim |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | - Modernizimi i legjislacionit nacional me qëllim të krijimit të bazës ligjore për luftë më efikase kundër trafikimit me qenie njerëzore në pjesën e bashkëpunimit ndërkombëtar |
| **4.3. Trajtimi policor dhe gjyqësor i viktimave /dëshmitarëve** | | | | | |
| | 1. Nënshkrimi i Memorandumit për bashkëpunim midis MPB-së dhe IOM-it për vendosjen e procedurave operative standarde në lidhje me aktivitetet e tyre të përbashkëta rreth personave të trafikuar si dhe mbështetja dhe ndihma e tyre | | | | 1. Bashkëpunim i përmirësuar midis palëve të involvuara; - nivel i përmirësuar i ndihmës dhe mbështetjes të personave të trafikuar |
| | 2. Nënshkrimi i Memorandumit për bashkëpunim midis MPB-së dhe OJQ-ve | | | | 2. Bashkëpunim i përmirësuar midis palëve të involvuara – inkuadrim më i mirë nga ana e OJQ-ve |



QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
KOMISIONI NACIONALPËR LUFTË KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ
DHE MIGRIMIT ILEGAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

# KOMISIONI NACIONAL I LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE DHE MIGRIMIT ILEGAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

## Nëngrupi për luftën kundër trafikimit të fëmijëve

# PLANI AKSIONALI LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT ME FËMIJË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Shkup, mars 2006

# PËRMBAJTJA


**HYRJE ........................................ 53**

**QËLLIME TË PËRGJITHSHME ........................................ 53**

**DREJTIMET THEMELORE DHE PRIORITETET E PLANIT AKSIONAL ........................................ 54**

**DEFINIMI I TRAFIKIMIT ME FËMIJË ........................................ 54**

**REFORMAT JURIDIKE ........................................ 55**

1. Kodi penal i Republikës së Maqedonisë ........................................ 55
2. Ligji për procedurë penale ........................................ 55
3. Ligji për familjen ........................................ 55
4. Ligji për mbrojtjen e fëmijëve ........................................ 55
5. Ligji për mbrojtjen sociale ........................................ 55
6. Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm ........................................ 56
7. Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve ........................................ 56
8. Ligji për të drejtën e të miturve ........................................ 56

**VLERËSIMIMI I GJENDJES ........................................ 57**

1. Hulumtimet/analizat/studimet për paraqitjen e trafikimit me fëmijë ........................................ 57
2. Identifikimi i mjediseve, komuniteteve dhe i grupeve të rrezikut të fëmijëve dhe të familjeve të cilat bartin rrezik të madh për paraqitjen e trafikimit me fëmijë ............ 57

**PARANDALIMI**

1. Informimi dhe ngritja e vetëdijes për trafikimin me fëmijë dhe grupet e rrezikut .......... 58
2. Ndërmarrja e masave nga ana e shtetit për stimulimin e edukimit të fëmijëve dhe krijimit të politikës më të mirë të shpërndarjes së mjeteve buxhetore duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijëve ........................................ 59
3. Njohja e fëmijëve me të drejtat e tyre dhe edukimi i tyre për njohjen e faktorëve të rreziqeve dhe vetëmbrojtja nga trafikimi ........................................ 59
4. Identifikimi i fëmijëve/ viktima të trafikimit ........................................ 59

MBROJTJA DHE NDIHMA PËR FËMIJËT – VIKTIMA/ DËSHMITARË ..................................60

1. Sigurimi i standardeve minimale për trajtim, ndihmë dhe mbrojtje të fëmijëve – viktima të trafikimit........................................................ 60
2. Pengimi i viktimizimit të mëtutjeshëm të fëmijëve viktima të trafikimit........................... 61

REHABILITIMI, REINTEGRIMI DHE REPATRIIMI ..............................................................62

1. Rehabilitimi, reintegrimi dhe repatriimin i fëmijëve viktima të trafikimit ......................... 62
2. Mbështetja e familjeve të fëmijëve viktimat të trafikimit dhe mbështetja e shtëpive - familje............................................................................ 62

KOORDINIMI I KOMPETENCAVE TË INSTITUCIONEVE NACIONALE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR...........................................................................63

1. Bashkëpunimi dhe koordinimi i organeve gjegjëse qeveritare dhe i institucioneve, organizatave ndërkombëtare dhe joqeveritare me qëllim të vendosjes së sistemit efikas për identifikimin, udhëzimin, pranimin dhe dhënien e ndihmës dhe mbrojtjes së fëmijëve viktima/ dëshmitarë dhe ndjekja penale e kryesve të veprimeve......................................................................................... 63
2. Vendosja dhe përforcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar për lehtësimin e procesit të repatriimin të fëmijëve viktima/ dëshmitarë në vendin e prejardhjes ose vendosja e tyre në shtetet e treta.................................................................. 63

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I IMPLEMENTIMIT TË PLANIT AKSIONAL I LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT TË FËMIJËVË...................................................................64



## HYRJE

Me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve në Republikën e Maqedonisë nga trafikimi dhe eksploatimi ilegal, si dhe me qëllim të dhënies së prioritetit të të drejtave dhe interesave të fëmijëve, Republika e Maqedonisë e miratoi Planin aksional të luftës kundër trafikimit me fëmijë. Republika jonë, si anëtare e Kombeve të Bashkuara dhe si nënshkruajtëse e Konventës së të drejtave të fëmijëve dhe të Planit botëror për aksion, është obliguar të verifikojë strategjinë nacionale për implementimin e Konventës së të drejtave të fëmijëve në rregullativën legjislative dhe në praktikë.

Plani aksional i luftës kundër trafikimit me fëmijë bazohet në Konventën e të drejtave të fëmijëve, në Deklaratën për obligueshmëri të nënshkruar në forumin e katërt ministror në kornizat e Paktit të stabilitetit për Evropën Juglindore të mbajtur më 10.02.2002 në Sofje, në dispozitat e Programit Nacional të luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimit ilegal, miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë më 05.02.2002, në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në protokollin fakultativ për shitblerjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë fëmijërore, në konventën për të drejtat e fëmijëve, në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional dhe në Protokollin për parandalimin, pengim dhe ndëshkim të trafikimit me qenie njerëzore, në veçanti me femra dhe fëmijë.

Plani aksional i luftës kundër trafikimit me fëmijë bazohet në katër parimet themelore duke përfshirë këtu parimet themelore të Konventës për të drejtat e fëmijëve edhe atë:

- mbrojtjen e të drejtave – përfshirë këtu edhe mbrojtjen prej diskriminimit nga të gjitha format e keqpërdorimit, lënien pas dore dhe eksploatimin;
- ë drejtën e mbijetimit dhe zhvillimit përfshirë këtu edhe të drejtën për qëndrim në vendet e pranimit, me mundësinë e qasjes deri te institucionet shëndetësore, institucionet arsimore, mbrojtjen e të drejtës prej eksploatimit ekonomik dhe mbrojtjen e zhvillimit fizik, psikik dhe mental të fëmijëve;
- pjesëmarrjen e fëmijëve në sjelljen e vendimeve që lidhen me të drejtat dhe interesat e tyre, si dhe me ndikimin e tyre në të gjitha çështjet, që i përkasin të drejtave dhe interesave të tyre – përfshirë këtu edhe të drejtën për formimin dhe prezantimin e pikëvështrimeve, mendimeve të tyre dhe të drejtës për të marrë informata të kapshme dhe të kuptueshme për ta, që do t`u kontribuonin për mirëqenien e tyre, si edhe për mbrojtjen nga ndikimi i dëmshëm i informatave, materialeve dhe përmbajtjeve të tjera
- interesin e fëmijëve e ka prioritet absolut gjatë krijimit të politikës qeveritare dhe gjatë sjelljes së vendimeve të secilit individ, institucion ose organ legjislativ.

## QËLLIMET E PËRGJITHSHME

Plani aksional ka për qëllim t`i sigurojë Republikës së Maqedonisë mjete dhe mekanizma për implementimin e përpjekjeve të saja në luftën kundër trafikimit me fëmijë dhe përparim të koordinimit midis institucioneve qeveritare, sektorit qeveritar dhe atij joqeveritar në luftën kundër trafikimit me fëmijë.

Me Planin aksional duhet të sigurohen mekanizmat dhe praktikat e reja për tejkalimin e problemeve në luftën kundër trafikimit me fëmijë, përfshirë këtu edhe mbrojtjen e fëmijëve viktima të trafikimit, pengimin e trafikimit dhe eksploatimit të fëmijëve, si dhe ndjekjen penale të atyre që kryejnë trafikim dhe eksploatim të fëmijëve ose ndihmojnë gjatë kryerjes së këtyre veprave penale.

Plani aksional për pengimin e trafikimit me fëmijë ka për qëllim:

- të përparojë politikën e Republikës së Maqedonisë lidhur me luftën kundër trafikimit me fëmijë dhe eksploatimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve viktima të trafikimit për një periudhë prej trevjetësh
- të vendosë minimum standarde për të siguruar mbrojtje të grupeve të rrezikut të fëmijëve, fëmijëve të eksploatuar me punë dhe të lënë pas dore si viktima potenciale të trafikimit me fëmijë;
- të mbrojë Interesin e fëmijëve dhe ky të ketë përparësi primare nën mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve-viktima;
- të mos përjashtohet asnjë fëmijë nga sigurimi i dhënies së mbrojtjes gjegjëse nga involvimi në trafikim ose si viktimë e trafikimit;
- të ndërmerren masa parandaluese për zvogëlimin e arsyeve dhe rreziqeve të cilat sjellin deri tek paraqitja dhe rritja e trafikimit dhe eksploatimit të fëmijëve;
- t'iu sigurohet mbrojtje e veçantë fëmijëve me nevoja të veçanta, si viktima të trafikimit;
- të inkuadrohen fëmijët me mendimet dhe vendimet e tyre në ndërmarrjen e masave për mbrojtjen nga trafikimi;
- të ndërmerren aktivitete për identifikimin, rehabilitimin dhe reintegrimin e fëmijëve-viktima të trafikimit me fëmijë.

Me Planin aksional për luftën kundër trafikimit me fëmijë bashkohen të gjitha detyrat dhe qëllimet të cilat Republika e Maqedonisë duhet t`i ndërmarrë me qëllim që të parandalojë dhe pengojë trafikimin me fëmijë dhe t`i mbrojë fëmijët-viktima të trafikimit, në bazë të parimeve të barazisë, qasjes, cilësisë dhe efikasitetit.

Teksti i punës të Planit aksional nacional (PAN) i ndjek udhëzimet e "Udhërrëfyesit" të UNICEF-it për masat e veçanta të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve-viktima, të trafikimit në Evropën Juglindore që nga viti 2003.

## DREJTIMET THEMELORE DHE PRIORITETET E PLANIT AKSIONAL

Me qëllim të realizimit të qëllimeve të planit aksional janë verifikuar drejtimet dhe prioritetet vijuese:

- implementimi i tërësishëm i konventës për të drejtat e fëmijës, i Protokollit fakultativ, bashkangjitur me Konventën për shitblerjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve dhe i dokumenteve të tjera ndërkombëtare që verifikojnë mekanizmat dhe obligimet për mbrojtjen e fëmijëve prej trafikimit me qenie njerëzore dhe llojeve të tjera të dhunës dhe të keqpërdorimit;
- vendosja e mekanizmave dhe e mënyrave adekuate për koordinimin e subjekteve të involvuara gjatë zbatimit të rregulativës legjislative dhe detyrave programore;
- sigurimi i burimeve të mundshme të mjeteve për pengimin e trafikimit me fëmijët dhe mbrojtjen e fëmijëve viktima të trafikimit;
- edukimi i fëmijëve për njohjen e të drejtave dhe obligimeve të tyre dhe përfitimi i shkathtësive për vetëmbrojtje dhe edukim të tillë që do t`iu sigurojë fëmijëve mbrojtje dhe ngritje të vetëdijes për ekzistimin e trafikimit me fëmijë si edhe për nevojën e një lufte pa kompromis të të gjithëve kundër trafikimit me fëmijë;
- sjellje të zgjidhjeve adekuate ligjore dhe ndryshim të praktikave për mbrojtjen e fëmijëve;
- përparim të bashkëpunimit midis institucioneve qeveritare, si edhe midis sektorit qeveritar dhe atij joqeveritar në aspektin e sigurimit të ndihmës dhe të mbrojtjes së fëmijëve.

## DEFINICIONI I TRAFIKIMIT ME FËMIJË

Përshtatja e definicionit të nocionit fëmijë në legjislacionin nacional me standardet ndërkombëtare (Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve, Protokollin e

Kombeve të Bashkuara për parandalim, pengim dhe ndëshkim të trafikimit me qenie njerëzore, ne veçanti me femrat dhe me fëmijët).

Plani aksional e pranon definicionin për trafikim me qenie njerëzore të përfshirë në Protokollin e Palermos dhe në mënyrë adekuate të implementuar në nenin 418-a „***Trafikim me qenie njerëzore***" prej Kodit penal, i definuar si vepër penale e veçantë e kryer ndaj fëmijëve deri në moshën 18 vjeçare dhe me plotësim se si trafikim me fëmijë do të trajtohen edhe rastet kur fëmija është dakorduar për trafikim në mënyrë vullnetare, gjegjësisht për eksploatim seksual ose çfarëdo lloji tjetër eksploatimi..

## REFORMAT JURIDIKE

Nevoja për ndryshime dhe plotësime të ligjeve ekzistuese dhe akteve të tjera normative, që e trajtojnë problemin e fëmijëve, gjatë së cilës është e nevojshme të ndryshohen dhe plotësohen si vijon:

1. Kodi penal i Republikës së Maqedonisë:
   - me normimin e nenit të ri për trafikimin e fëmijëve, gjegjësisht trafikimi me fëmijë të parashikohet si vepër e veçantë penale;
   - të parashikohet dënimi edhe për tentim të kryerjes së kësaj vepre penale;
   - trafikimi me fëmijë të parashikohet si formë e kualifikuar e të drejtës penale edhe atëherë, nëse vepra është kryer nga ana e prindërve.

2. Ligji për procedurë penale:
   - të parashikohet domosdo sigurimi i ndihmës juridike pa pagesë në procedurën penale në të cilën viktima është fëmijë i trafikuar;
   - dëshmimi i fëmijëve viktima të jetë në një dhomë të pajisur në mënyrë të veçantë dhe në praninë e personave të trajnuar në mënyrë të veçantë për këtë kategori fëmijësh: me gjykatës, punëtor social, psikolog dhe avokat;;

3 Ligji për familjen:
   - të parashikohet kryerja e domosdoshme e vëzhgimit mbi të drejtën prindërore nga ana e qendrave për punë sociale mbi familjet ku ekzistojnë indicie dhe rreziqe të involvimit të fëmijëve në trafikim, ose në ndonjë formë tjetër të punës së dhunshme
   - përgatitja e fëmijëve-viktima trafikimi të kthehen në jetën normale në familjet e tyre, të cilat do të kujdesen në mënyrë adekuate për zhvillimin e mëtutjeshëm të tyre, por me përkujdesje të pandërprerë të ekipit profesional të qendrës për punë sociale të përbërë nga një punëtor social, psikolog dhe punëtor shëndetësor;
   - nëse nuk ekzistojnë kushte për kthyerjen e fëmijës në familjen e tij të parashikohet si zgjidhje prioritare vendosja e tij në një familje tjetër, e cila është e trajnuar në mënyrë të veçantë për kujdes me kategori të këtillë fëmijësh dhe të cilëve shteti iu ka siguruar ndihmë të jashtëzakonshme materiale dhe profesionale për kryerjen e kësaj pune;
   - fëmijëve viktima të trafikimit, pa prindër ose pa përkujdesje prindërore, ose fëmijëve të këtillë të një shteti të huaj, t'iu përcaktohet domosdo një person që do të kujdeset për ta.

4. Ligji për mbrojtjen e fëmijëve:
   - parashikimi i masave të veçanta për inkuadrim të fëmijëve-viktima të trafikimit ose në ndonjë lloj tjetër aktiviteti të dhunshëm në institucionet arsimore si dhe rehabilitimi dhe risocializimi i tyre.

5. Ligji për mbrojtje sociale:
   - parashikimi i masave për zvogëlimin e varfërisë, gjegjësisht të garantimit dhe sigurimit të mjeteve minimale për ekzistimin e familjeve që kanë fëmijë të mitur, të cilëve nëpërmjet punësimit ose ndonjë mënyrë tjetër nuk mund t`iu sigurohet realizimi i mjeteve për ekzistencë; ndërmarrje të masave sociale për familjet me fëmijë- viktima trafikimi, ose të ndonjë lloji tjetër të punës së dhunshme për shkak të gjendjes së tyre të vështirë sociale;
   - parashikimi i një sistemi përkatës për identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve nëpër rrugë, ose të fëmijëve të eksploatuar

me punë; ndërmarrja e masave përkatëse për mbrojtjen e tyre me vendosjen e tyre nëpër qendra ditore; ndihma dhe edukimi i fëmijëve dhe i prindërve të tyre, si dhe lidhja me qendrat ditore dhe institucionet arsimore me qëllim të inkuadrimit të këtyre fëmijëve në arsimimin e rregullt;
- masat të cilat do të ndërmerren ndaj kësaj kategorie fëmijësh jashtë qendrës ditore (në familje, në shkollë dhe para institucioneve të tjera) të jenë në vëzhgim të përhershëm nga punëtori social dhe psikologu i qendrës për punë sociale;
- krijimi i obligimeve për formimin e vendeve të pranimit për fëmijët-viktima të trafikimit në vendet e pranimit në të cilat duhet të angazhohen punëtori social, psikologu dhe punëtori shëndetësor;
- në vendet e pranimit të angazhohen persona të besueshëm dhe të trajnuar në mënyrë të veçantë dhe vendvendosja e vendeve për pranim të jetë e njohur vetëm për një qark të caktuar njerëzish, që do të obligohen për ndërmarrjen e masave përkatëse për mbrojtjen e fëmijëve.

6. Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm:
   - prezantimi i të drejtave të njeriut si përmbajtje e domosdoshme në planet dhe programet mësimore në të gjitha shkallët e arsimit fillor dhe të mesëm;
   - inkuadrimi i fëmijëve në shkollë në sjelljen e vendimeve, që lidhen me të drejtat dhe interesat e tyre;
   - pajisja e shkollave në bazë të standardeve të përcaktuara me qëllim të sigurimit të kushteve gjegjëse për arsimim, gjegjësisht shkollat t`u bëhet fëmijëve mik i vërtetë;
   - trajnimi i personelit mësimdhënës me qëllim të aftësimit të fëmijëve me dituri dhe shkathtësi për vetëmbrojtje prej të gjitha llojeve të lëndimeve dhe të keqpërdorimeve.

7. Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve:
   - fëmijëve-viktima të trafikimit që dëshirojnë dhe janë në gjendje të dëshmojnë në procedurat kundër personave të inkuadruar në vargun e trafikimit me fëmijë t'iu përcaktohet domosdo një person shoqërues, i cili do t'iu ndihmojë dhe do t`i shoqërojë në të gjitha procedurat para të gjitha organeve dhe institucioneve.

8. Ligji për të drejtën e të miturve

   Republika e Maqedonisë, si anëtare e Kombeve të Bashkuara, e Këshillit të Evropës dhe si nënshkruase e Marrëveshjes për stabilizim dhe asociim, e në veçanti duke e pasur në konsiderim se Parlamenti i Republikës së Maqedonisë në 24. 09. 2004 e miratoi ligjin për ratifikimin e konventës së Palermos me protokollet e saj, ndërmorri aktivitete për implementimin e të gjitha normave dhe standardeve ndërkombëtare, që e rregullojnë çështjen e delikuencës së personave të mitur dhe sistemin e të drejtës së personave të mitur, prandaj R. e Maqedonisë nevojitet të sjellë një ligj të veçantë për të drejtën e personave të mitur. Me këtë ligj duhet të parashikohen masat e aktiviteteve parandaluese dhe pengimi të delikuencës së personave të mitur, masat për mbrojtjen e fëmijëve, që janë në kundërthënie me ligjin, të parashikohen më shumë alternativa, gjegjësisht masa jashtagjyqësore dhe masa për risocializim dhe rehabilitim të fëmijëve që janë në kundërthënie me ligjin. Në të njëjtën kohë me këtë ligj duhet të parashikohen edhe masat për mbrojtjen e fëmijëve-viktima dhe të dëmtuar.

## QËLLIMI AFATSHKURTËR

- Të bëhet ratifikimi i konventave ndërkombëtare dhe protokolleve (Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional, Protokolli i Kombeve të Bashkuara për parandalim, pengim dhe ndëshkimin e trafikimit me qenie njerëzore, në veçanti me femra dhe me fëmijë dhe Konventa e Hagës numër 33 për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin lidhur me adoptimet ndërshtetërore të fëmijëve).

- Nënshkrimi dhe ratifikimi i Konventës së Hagës është vlerësuar si QËLLIM AFATMESËM. Lidhur me ratifikimin e konventës së Hagës, UNICEF-i gjatë vitit të kaluar ka lobuar në Ministrinë e punës dhe politikës sociale lidhur me këtë çështje. Lobimi në këtë plan do të vazhdojë edhe në periudhën e mëtutjeshme. OSBE-ja do t`i mbështesë reformat juridike me komente të specialistëve.

REZULTATET E PRITURA: -sigurimi i kornizës ligjore, realizimi i suksesshëm i ndryshimeve dhe i plotësimeve (shtesave) të propozuara të Kodit penal.
BARTËS: Ministria e drejtësisë.
PARTNERË: Ministritë e resorëve, organizatat joqeveritare të vendit dhe organizatat ndërkombëtare (UNICEF, OSBE, IOM).
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Ministria e drejtësisë me mbështetje të mundshme prej organizatave ndërkombëtare - donacione).
AFATI: Deri në fund të vitit 2006

## VLERËSIMI I GJENDJES (I SITUATËS)

1. Hulumtime/analiza/studime për paraqitjen e trafikimit me fëmijë

### *AKTIVITETET*

a) Përcaktimi dhe definimi i faktorëve të rrezikut të trafikimit me fëmijë dhe zvogëlimi i arsyeve socio–ekonomike të cilat sjellin paraqitjen e trafikimit me fëmijë (varfërinë, jostabilitetin ekonomik, papunësinë, diskriminimin, statusin e femrave dhe fëmijëve, disfunksionalitetin e familjeve etj)
b) përgatitje dhe publikim i raporteve dhe i statistikave relevante për trafikimin e fëmijëve në nivel nacional dhe ndërkombëtar;
c) monitorim dhe vlerësim i vazhdueshëm i implementimit të propozim-planit të veprimit;
d) vlerësim i gjithmbarshëm dhe planifikim i rrjetit të zyrave dhe shërbimeve të mundshme për fëmijët-viktima të trafikimit.

REZULTATET E PRITURA: posedimi i të dhënave relevante dhe shpërndarja e tyre.
BARTËS I AKTIVITETEVE: MPB
PARTNERË: Ministria për punë dhe politikë sociale, Ministria e arsimit dhe Ministria e drejtësisë si edhe organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare.
AFATI: Deri në fund të vitit 2008

2. Identifikimi i mjediseve, komuniteteve dhe grupeve të rrezikut të fëmijëve dhe të familjeve të cilat bartin rrezik të madh për paraqitjen e trafikimit me fëmijë.

### *AKTIVITETET*

a) Zhvillimi i instrumenteve, metodologjive dhe i indikatorëve në përputhje me standardet ndërkombëtare, me qëllim të monitorimit të paraqitjes së trafikimit me fëmijë;
b) vendosja e një sistemi për identifikim, regjistrim dhe monitorim të fëmijëve në rrugë (gjegjësisht të fëmijëve jashtë procesit të arsimimit), të keqpërdorimeve të punës së fëmijëve dhe formave të ndryshme të eksploatimit dhe diskriminimit. Aktivitetet do të jenë të orientuara kah trajtimi përkatës dhe mbrojtja e fëmijëve nëpërmjet formave të ndryshme të ndihmës, me qëllim të parandalimit të trafikimit (vendosja e tyre në familje nikoqire, qendra ditore dhe ngjashëm me këtë);
c) grumbullim i të dhënave dhe vendosja e një baze të të dhënash për fëmijët-viktima, për kryesit e veprës penale dhe shfrytëzuesit e shërbimeve, si edhe identifikimi i fëmijëve-viktima të trafikimit (shtetas të vendit dhe të huaj), fëmijëve që janë në rrezik prej trafikimit për shkak të ekzistimit të faktorëve të llojllojshëm të rrezikut, si edhe kryesit e veprave penale të këtij lloji.

REZULTATET E PRITURA: Mbrojtja përkatëse e fëmijëve–viktima potenciale dhe parandalime më adekuate.
BARTËS: Ministria e punës dhe politikës sociale.
PARTNERË: MPB, Qendrat për punë sociale, vetëqeverisja lokale.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Ministria e punës dhe politikës sociale (me mbështetje të mundshme prej organizatave ndërkombëtare - donacione).
AFATI: Fundi i vitit 2008

## PARANDALIMI

1. Informim dhe ngritje e vetëdijes për trafikimin me fëmijë dhe grupet e rrezikut.

### *AKTIVITETET*

a) Mbajtje e leksioneve parandaluese në shkollat fillore dhe të mesme, si edhe në institucionet e tjera edukativo – arsimore, me qëllim të informimit të fëmijëve dhe personelit mësimdhënës për problemin e trafikimit me fëmijë, shpërndarjes së broshurave dhe afisheve informative te mësimdhënësit dhe nxënësit nëpërmjet të planeve dhe programeve mësimore për edukimin qytetar në shkollë.

REZULTATET E PRITURA: Trajnim dhe aftësim i suksesshëm i një numri të madh fëmijësh të inkuadruar në procesin arsimor, në veçanti në grupet e rrezikut për trafikimin me fëmijë.
BARTËS: Ministria për arsim dhe Ministria e pushtetit lokal.
PARTNERË: Ministritë relevante, organizatat joqeveritare të vendit dhe organizata ndërkombëtare, vetëqeverisja lokale.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Ministria për arsim dhe Ministria e pushtetit lokal (me mbështetje të mundshme prej organizatave ndërkombëtare - donacione).
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

a) organizimi i fushatave mediale drejtuar kah informimi dhe senzibilimi i popullatës në përgjithësi për problemin e trafikimit me fëmijë, arsyet të cilat kontribuojnë për paraqitjen e tij dhe pasojat prej tij si dhe formimi i fondeve të vetëqeverisjes lokale për këtë qëllim, që do të sigurohen nëpërmjet aktiviteteve me donatorë;.
b) fushatë më e gjerë e mediave për informimin e prindërve (familjeve) dhe qytetarëve të tjerë me qëllim të njohjes së trafikimit me fëmijë dhe mbrojtjes prej saj.

REZULTATET E PRITURA: Senzibilimi i popullatës në përgjithësi, i prindërve në veçanti, për ekzistimin e trafikimit me fëmijë dhe njohjen e tij.
BARTËS: Ministria e arsimit.
PARTNERËT: Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë, ministritë relevante, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Ministria për arsim dhe Ministria e pushtetit lokal (me mbështetje të mundshme prej organizatave ndërkombëtare - donacione).
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

d) organizimi i seminareve informative dhe edukative për të punësuarit në institucionet shtetërore në nivel lokal dhe nacional, me animimin e vetëqeverisjes lokale lidhur me identifikimin e problemeve, me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe aktiviteteve parandaluese në kryerjen e detyrave profesionale, përfshirë këtu edhe Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, si krijues të politikës në lëmën e mbrojtjes së fëmijëve.

REZULTATET E PRITURA: Personel i trajnuar në institucionet shtetërore lokale dhe nacionale dhe identifikimi i problemit.
BARTËS: Ministria për arsim dhe Ministria e pushtetit lokal.
PARTNERËT: Nëngrupi për luftë kundër trafikimit me fëmijë, ministritë relevante, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare, njësitë e vetëqeverisjes lokale.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Ministria për arsim dhe Ministria e pushtetit lokal (me mbështetje të mundshme prej organizatave ndërkombëtare - donacione).
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

e) informimi dhe edukimi i prindërve dhe i familjeve të cilat janë të rrezikuara në aspektin social për rreziqet e trafikimit me fëmijë;
f) reintegrimi në shoqëri nëpërmjet të dhënies së granteve të vogla për vetëpunësim ose forma të tjera të ndihmës.

REZULTATET E PRITURA: Familje të edukuar në aspekt social dhe zvogëlimi i papunësisë.
BARTËS: Ministria për punë dhe politikë sociale.
PARTNERËT: Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë, ministritë relevante, organizatat

ndërkombëtare dhe joqeveritare dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Ministria për punë dhe politikë sociale (me mbështetje të mundshme prej organizatave ndërkombëtare - donacione)
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

g) trajnimi i organizatave joqeveritare në Republikën e Maqedonisë për zbatimin e aktiviteteve parandaluese të trafikimit me fëmijë;
h) trajnimi i përfaqësuesve të mediave me qëllim të njohjes së tyre me problemin e trafikimit me fëmijë dhe prezantimi më adekuat i rasteve nëpërmjet të mjeteve për informim publik..

REZULTATET E PRITURA: Inkuadrimi i kuadrit të trajnuar në sektorin joqeveritar në realizimin e masave të parashikuara parandaluese të shtetit. Prezantimi objektiv dhe përkatës për paraqitjen e trafikimit me fëmijë në mjetet e informimit publik.
BARTËS: Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë.
PARTNERËT: Ministritë relevante, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Organizatat joqeveritare me mbështetje financiare nga organizatat ndërkombëtare.
AFATI: deri në fund të vitit 2006

2) Ndërmarrja e masave nga ana e qeverisë për stimulimin e arsimimit të fëmijëve dhe krijimin e politikës më të mirë lidhur me shpërndarjen e mjeteve buxhetore duke pasur në konsiderim interesin më të mirë të fëmijëve.

### *AKTIVITETET:*

a) Inkuadrimi i të gjithë fëmijëve – inkluzioni në procesin e arsimimit i cili ngërthen në vete ndihmë materiale dhe ndihmë tjetër të qeverisë për të vizituar fëmijtë në institucionet arsimore.

REZULTATET E PRITURA: Zvogëlimi i numrit të fëmijëve që ndodhen jashta procesit të arsimimit, në veçanti të arsimit fillor.
BARTËS: Ministria e arsimit.
PARTNERË: Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë, MPB, ministritë relevante, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare, njësitë e vetëqeverisjes.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Ministria e arsimit.
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

3) Njohja e fëmijëve me të drejtat e tyre dhe edukimi i tyre për njohjen e faktorëve të rrezikut, si dhe vetëmbrojtja nga trafikimi.

a) Prezantim i të drejtave të njeriut si obligim i domosdoshëm në arsimimin formal dhe motivim i fëmijëve për praktikimin e tyre;
b) pjesëmarrje më aktive e fëmijëve në ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e tyre në parandalim dhe risocializim.

REZULTATET E PRITURA: Inkuadrimi adekuat i fëmijëve në vendimet që lidhen me të drejtat e tyre.
BARTËS: Të gjithë ministritë relevante.
PARTNERËT: Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë, ministritë relevante, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare, njësitë e vetëqeverisjes lokale, Agjencioni për sport dhe të rinjtë.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Ministria e arsimit.
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

4) Identifikimi i fëmijëve/ viktima të trafikimit.

### *AKTIVITETET:*

a) Ndërmarrja e masave të vendosjes së procedurave efikase për identifikimin e shpejtë të fëmijëve-viktima trafikimi nëpërmjet të vendosjes së këmbimit të koordinuar të informatave dhe të të dhënave midis policisë, shërbimeve kufitare, qendrave për punë sociale, shkollave, institucioneve shëndetësore, organizatave joqeveritare dhe Avokatit të popullit.

REZULTATET E PRITURA: veprim i koordinuar i shtetit dhe zvogëlimi numrit të errët të rasteve të këtij lloji të krimit.
BARTËS: Të gjitha ministritë relevante.
PARTNERËT: Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë, ministritë relevante, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare njësitë e vetëqeverisjes lokale.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Ministria e punës dhe politikës sociale (me mbështetje të mundshme prej organizatave ndërkombëtare - donacione).
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

b) përforcimi i kontrollit mbi kufijtë dhe vendkalimet ilegale nga ana e policisë kufitare dhe rritja e mbikëqyrjes nga ana e shërbimeve përgjegjëse për të huaj, veças kur fëmijët udhëtojnë pa shoqërimin e prindërve.

REZULTATET E PRITURA: Zvogëlimi i numrit të kalimeve ilegale të fëmijëve.
BARTËS: MPB
PARTNERË: Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë, ministritë relevante, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare, njësitë e vetëqeverisjes lokale.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: MPB
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

c) promovimi dhe mbështetja e linjës ekzistuese SOS e cila funksionon si OJQ për nevojat e fëmijëve dhe viktimave të reja të trafikimit, me inkuadrimin e përfaqësuesve të mediave si partnerë dhe zgjerimi i të njëjtës në nivel lokal me obligim të Qeverisë për gjetjen e zgjidhjes së përhershme;
d) përparimi dhe mbështetja e shtëpive këshilluese informative ekzistuese dhe linjave telefonike në sektorin joqeveritar në bashkëpunim me rrjetat lokale të OJQ-ve për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore në nivel lokal dhe nacional, që ofrojnë shërbime për informim dhe këshillim për rreziqet që lidhen me largimin e të rinjve jashtë shtetit me qëllim të punësimit të tyre ose të studimeve; këshillim juridik; ndihmë për realizimin e kontakteve me institucionet shtetërore; ndihmë psiko-sociale; mbështetje emocionale dhe intervenime në krizë; ndihmë për kthim në shtetin amë dhe drejtim kah shërbimet (departamentet) e tjera.

REZULTATET E PRITURA: Avancimi dhe mbështetja e linjave ekzistuese SOS. Zvogëlimi i viktimave potenciale të trafikimit.
BARTËS: OJQ
PARTNERËT: Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë, ministritë relevante dhe organizatat ndërkombëtare.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Organizatat joqeveritare me mbështetjen financiare të biznes-sektorit dhe organizatave ndërkombëtare.
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

## MBROJTJA DHE NDIHMA E FËMIJËVE–VIKTIMA/DËSHMITARË

1. Sigurimi i minimum-standardeve për trajtimin, ndihmën dhe mbrojtjen e fëmijëve viktima të trafikimit.

### *AKTIVITETET*

a) Formimi i ekipeve mobile multidisciplinare në qendrat për punë sociale, me përfaqësues të institucioneve kompetente, persona të kualifikuar (Qendra për punë sociale, Ministria e Punëve të Brendshme dhe OJQ-të), do të jenë 24 orë në dispozicion, me qëllim të implementimit të procedurave standarde gjatë zbulimit të fëmijës–viktimë trafikimi (pranimi fillestar dhe biseda – intervista me fëmijën dhe vendosja e tyre e përkohshme në institucione përkatëse).

REZULTATET E PRITURA: Qasje ekipore dhe mbrojtje më efikase e fëmijëve viktima të trafikimit.
BARTËS: Ministria e punës dhe politikës sociale.
PARTNERËT: Ministritë relevante, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Ministria e punës dhe politikës sociale (me mbështetje të mundshme prej organizatave ndërkombëtare -

donacione).
AFATI: deri në fund të vitit 2006

b) gjetja e kapaciteteve hapësinore përkatëse për vendosjen e fëmijëve–viktima/ dëshmitarë të trafikimit (vendosja e ndarë e fëmijëve të vendit tonë dhe e fëmijëve shtetas të huaj);
c) sigurimi i nevojave themelore ekzistenciale, ndihmë psikologjike, sociale, shëndetësore, edukative dhe juridike për fëmijët viktima/ dëshmitarë të trafikimit, të vendosur në qendrat e pranimit;.
AFATI: deri në fund të vitit 2006
d) adaptimi i hapësirave në Qendrën ekzistuese të tranzitimit për të huaj, për fëmijët shtetas të huaj dhe adaptimi i hapësirave të institucioneve ekzistuese për mbrojtjen e fëmijëve, për pranimin fillestar të fëmijëve viktima nga Republika e Maqedonisë.
AFATI: deri në fund të vitit 2006
e) gjetja e zgjidhjes së përhershme, gjegjësisht objektit me karakter të përhershëm për vendosjen e përbashkët të fëmijëve-viktima, shtetas të vendit dhe shtetas të huaj;
f ) organizimi i vendeve të pranimit në mjediset ku trafikimi me fëmijët është më i theksuar.
AFATI: Deri në fund të vitit 2008

REZULTATET E PRITURA: Vendosja e organizuar dhe mbështetja e fëmijëve-viktima.
BARTËS: MPB dhe Ministria e punës dhe politikës sociale.
PARTNERËT: Ministritë e tjera relevante dhe organizatat ndërkombëtare (UNICEF-i, IOM dhe OSBE).
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: MPB dhe Ministria e punës dhe politikës sociale dhe organizatat joqeveritare (me mbështetje të mundshme prej organizatave ndërkombëtare - donacione);

g) identifikimi i shpejtë dhe efikas i fëmijëve viktima/dëshmitarë dhe emërtimi i personit të tyre për përkujdesje sipas detyrës zyrtare, personi-shoqërues (përfaqësues i OJQ-së);
h) organizimi i vendeve të pranimit në mjediset ku është më i theksuar trafikimi me fëmijët;
i) sigurimi i ndihmës juridike pa pagesë dhe përkthimi në gjuhën amtare.
j) gjetja e zgjidhjes së përhershme, gjegjësisht objektit me karakter të përhershëm për vendosjen e përbashkët të fëmijëve viktima, shtetas të vendit dhe shtetas të huaj;
k) gjetja e familjeve nikoqire për vendosjen e fëmijëve viktima të trafikimit.

REZULTATET E PRITURA: -Vendosja e organizuar dhe mbështetja e fëmijëve-viktima;
-dhënia e ndihmës përkatëse dhe zvogëlimi i viktimizimit të fëmijëve – viktima.
BARTËS: MPB dhe Ministria e punës dhe politikës sociale, gjegjësisht qendrat për punë sociale.
PARTNERËT: Ministritë e tjera të resorëve, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të.
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: MPB dhe Ministria e punës dhe politikës sociale si dhe organizatat joqeveritare (me mbështetje të mundshme prej organizatave ndërkombëtare - donacione).

2. Pengimi i viktimizimit të mëtutjeshëm të fëmijëve viktima të trafikimi.

***AKTIVITETE:***

a) Trajnimi i përfaqësuesve i të gjitha institucioneve kompetente për ndihmë dhe mbrojtje të viktimave, që në çfarëdo mënyrë, veças në mënyrë profesionale, kanë pika të përbashkëta me problemin e trafikimit me fëmijët (gjykatës, prokurorë publik, avokatë, juristë, punëtorë socialë, psikologë, pedagogë, defektologë, punëtorë shëndetësorë, pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të organizatave joqeveritare), për implementimin e masave të veçanta në mbrojtjen e fëmijëve viktima/ dëshmitarë të trafikimit në të gjitha fazat e tij, duke filluar nga identifikimi, mbrojtja, madje deri në rehabilitimin, reintegrimin dhe repatriimin përfundimtar të fëmijëve;
b) aplikimi i teknikave të veçanta për kryerjen e bisedave me fëmijët-viktima/dëshmitarë, me respektimin e të drejtave të tyre themelore dhe respektimin e personalitetit dhe dinjitetit të tyre, dhe
c) sigurimi i ndihmës përkatëse për fëmijët

me nevoja të veçanta viktima-trafikimi në raste të invaliditetit, çrregullimeve psikike, sëmundjeve dhe të shtatëzanisë.

REZULTATET E PRITURA: krijimi i personelit të aftësuar për sjellje përkatëse me viktimat e trafikimit me fëmijë.
BARTËS: MPB dhe Ministria e punës dhe politikës sociale dhe Ministria e arsimit.
PARTNERËT: Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë, ministritë relevante dhe organizatat joqeveritare.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Organizatat joqeveritare, MPB dhe Ministria e punës dhe politikës sociale dhe Ministria e arsimit (me mbështetje të mundshme prej organizatave ndërkombëtare - donacione).
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

## REHABILITIMI, REINTEGRIMI DHE REPATRIIMI

1. Rehabilitimi, reintegrimi dhe repatriimin i fëmijëve viktima të trafikimit.g

### *AKTIVITETE*

a) Rehabilitimi dhe përgatitja për reintegrim në mjedisin jetësor do të bëhet në qendrën e pranimit, nëpërmjet të dhënies së mbështetjes psiko-sociale dhe trajnimit të aftësive shoqërore për reintegrimin e fëmijëve viktima trafikimi;
b) implementimi i zgjidhjeve të përhershme për fëmijët-viktima/ dëshmitarë në familje dhe vendosja e tyre në familje të tjera.

REZULTATET E PRITURA: Fëmijë të aftësuar për reintegrim më të suksesshëm në mjedis.
BARTËS: OJQ, Ministria e punës dhe politikës sociale.
PARTNERË: Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë, ministritë relevante dhe organizatat ndërkombëtare.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Organizatat joqeveritare dhe Ministria e punës dhe politikës sociale (me mbështetje të mundshme të organizatave ndërkombëtare - donacione).
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

c) përforcimi dhe përparimi i OJQ-ve të cilat japin mbështetje psiko-sociale dhe ndihmë për fëmijët-viktima trafikimi.

REZULTATET E PRITURA: Personel i edukuar në OJQ-të i cili do të punojë me këtë problematikë.
BARTËS: OJQ
PARTNERË: Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë, ministritë relevante dhe organizatat ndërkombëtare.
AFATI: Deri në fund të vitit 2006
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Organizatat joqeveritare (me mbështetje të mundshme të organizatave ndërkombëtare - donacione).

d) repatriimi i fëmijëve-viktima të trafikimit me qenie njerëzore në shtetet e tyre amë ose vendosja e tyre në shtete të treta.

REZULTATET E PRITURA: Fëmijët-viktima të trafikimit të vendosen në mjedise të sigurta në përputhje me interesin më të mirë të tyre.
BARTËS: Ministria e Punëve të Brendshme.
PARTNERË: Ministria e punës dhe politikës sociale, Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë, ministritë relevante dhe organizatat ndërkombëtare.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Ministria e Punëve të Brendshme dhe organizatat joqeveritare (me mbështetje të mundshme të organizatave ndërkombëtare - donacione).
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

2. Mbështetja e familjeve të fëmijëve-viktima të trafikimit dhe mbështetja e familjeve nikoqire.

### *AKTIVITETE*

a) Mbështetje materiale dhe profesionale nga ana e qeverisë për familjet, që do t`i pranojnë fëmijët-viktima të trafikimit dhe mbikëqyrja e tyre nga ana e Ministrisë për punë dhe politikë sociale;
b) fushatë informative për popullatën e përgjithshme në Republikën e Maqedonisë me qëllim të nxitjes së numrit më të madh të familjeve (familje nikoqire) për pranimin dhe qëndrimin e fëmijëve viktima trafikimi dhe

trajnimi i tyre gjegjës, si edhe parashikimi i mbështetjeve dhe benificioneve të tjera materiale.

REZULTATET E PRITURA: Numri i duhur i familjeve të aftësuara për pranimin dhe vendosjen e fëmijëve viktima dhe dhënia e mbështetjes përkatëse.
BARTËS: Ministria e punës dhe politikës sociale.
PARTNERË: Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë, MPB, ministritë relevante, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare, njësitë e vetëqeverisjes lokale .
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Ministria e punës dhe politikës sociale dhe organizatat joqeveritare (me mbështetje të mundshme të organizatave ndërkombëtare - donacione).
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

.

## KOORDINIMI ME INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE NACIONALE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

1. Bashkëpunimi dhe koordinimi i organeve dhe institucioneve përkatëse qeveritare, i organizatave ndërkombëtare dhe joqeveritare me qëllim të vendosjes së një sistemi efikas të identifikimit, drejtimit, pranimit dhe dhënies së ndihmës dhe mbrojtjes për fëmijët-viktima/ dëshmitarë, si dhe ndjekja penale e kryesve të veprave penale.

a) Nënshkrimi i memorandumit për mirëkuptim (bashkëpunim) me të gjitha institucionet relevante;

b) nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale sipas nevojës, për bashkëpunim me shtete prej të cilave dhe në të cilat janë fëmijët viktima – dëshmitarë të trafikimit, me qëllim të parandalimit të trafikimit dhe sigurimit të kthyerjes së tyre të sigurtë.

REZULTATET E PRITURA: Bashkëpunim më i mirë dhe koordinim efikas në nivel nacional, rajonal dhe ndërkombëtar.
BARTËS: Ministria e Punëve të Jashtme.
PARTNERË: Të gjitha ministritë relevante.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Ministria e Punëve të Jashtme.
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008.

2. Vendosja dhe përforcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar për lehtësimin e procesit të repatriimit të fëmijëve-viktima/dëshmitarë në shtetin e origjinës ose vendosjen e tyre në shtete të treta.

REZULTATET E PRITURA: Bashkëpunim më i mirë dhe koordinim efikas në nivel nacional, rajonal dhe ndërkombëtar.
BARTËS: Ministria e Punëve të Brendshme dhe IOM-i.
PARTNERË: Të gjitha ministritë relevante, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Ministria e Punëve të Brendshme dhe IOM-i.
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

a) Formimi dhe shfrytëzimi i rrjetave rajonale tani më ekzistuese për këmbimin e informatave, të dhënave dhe eksperiencave të nëngrupeve për parandalimin e trafikimit me fëmijë në Evropën Juglindore dhe më gjerë.

REZULTATET E PRITURA: Zvogëlimi i numrit të viktimave prej trafikimit me fëmijë, ndjekja dhe informimi, si edhe shfrytëzimi i eksperiencave dhe ekspertizave të huaja dhe transparenca gjatë bashkëpunimit.
BARTËS: Komisioni nacional për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimin ilegal, si dhe Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijë.
PARTNERË: Të gjitha ministritë relevante, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare.
BARTËS I HARXHIMEVE FINANCIARE: Organizatat joqeveritare (me mbështetje të mundshme të organizatave ndërkombëtare - donacione).
AFATI: Në kontinuitet deri në vitin 2008

## MONITORIMI DHE VLERËSIMI I IMPLEMENTIMIT TË PLANIT AKSIONAL PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE

Përcjellja e implementimit të Planit aksional për luftë kundër trafikimit të fëmijëve do të bëhet nga ana e Komisionit nacional për luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë.

Për aktivitetet e nëngrupit do të informohet Komisioni nacional për luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore në çdo gjashtë muaj, ndërsa sipas nevojës edhe më herët, ndërsa Komisioni nacional do të informojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe Parlamentin e Republikës së Maqedonisë.

Nëngrupi i cakton afatet:

- qëllimi afatshkurtër: deri në fund të vitit 2006;
- qëllimi afatmesëm: një vit pas miratimit të Planit aksional nacional (fundi i vitit 2007);
- Qëllimi afatgjatë: dy vjet pas miratimit të Planit aksional nacional (fundi i vitit 2008).